Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION

UDHËZUES PRAKTIK PËR HARTIMIN E PLANIT INDIVIDUAL PËR NXËNËSIT ME INTELIGJENCË TË JASHTËZAKONSHME, DHUNTI DHE TALENTE

2021

UDHËZUES PRAKTIK PËR HARTIMIN E PLANIT INDIVIDUAL PËR NXËNËSIT ME INTELIGJENCË TË JASHTËZAKONSHME, DHUNTI DHE TALENTE

Përmbajtja

Qëllimi i këtij udhëzuesi....5
Hyrje....5
Çfarë është plani individual....6
Kujt i dedikohet Plani Individual? 6
Kur duhet filluar me hartimin e Planit Individual?....7
Kush është përgjegjës për hartimin, implementimin dhe zbatimin e Planit individual?....7
Qëllimi i planit individual....8
II. KRIJIMI I NJË VIZIONI TË PËRBASHKËT: Palët e përfshira në procesin e hartimit të Planit Individual....9
Përfshirja e nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme....11
STRATEGJI: Si të nxisim metakognicionin te nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme....14
STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e identifikimit të anëve të forta dhe nevojave....15
STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e vendosjes së qëllimeve....16
STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e implementimit të Planit Individual....17
STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e rishikimit të Planit Individual....17
Përfshirja e prindërve 17
STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë bashkëpunimin me prindërit.20
STRATEGJI: Si të tejkalojmë konfliktet dhe të zgjidhim problemet me prindërit....21
Përfshirja e stafit shkollor (drejtorit, psikologut të shkollës/pedagogut)....22
Përfshirja e individëve jashtë shkollës....26

III. PROCESI NËPËR TË CILIN KALON PLANI INDIVIDUAL: Nga hartimi deri te zbatimi....27
Takimet planifikuese dhe monitoruese....27
Identifikimi i nevojave....28

Vendosja e orientimit/ drejtimit (Çfarë duam të arrijmë me këtë plan).31
Përpilimi i planit.....32
Implementimi i planit.....34
Rishikimi dhe rishqyrtimi.....36
Planifikimi për tranzicion.....37
IV. BRENDA PLANIT INDIVIDUAL.....38
Informata për nxënësin.....38
Informata paraprake: Konteksti shkollor dhe përfshirja e prindërve...38
Identifikimi i anëve te forta 38
Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për përkrahje.....40
Aspektet shëndetësore që ndikojnë në mësim.....40
Të dhëna nga vlerësimet formale.....41
Niveli aktual i performancës dhe arritjeve.....42
Qëllimi afatgjatë dhe objektivat afatshkurta.....42
Procedurat e vlerësimit.....47
Rishikimi i progresit.....49
Përmbledhja e fundvitit.....50
Akomodimet dhe strategjitë për të përkrahur arritjen e qëllimit.....51
Informata shtesë.....53
Nënshkrimet.....54

V. SHTOJCA

Shtojca 1: Mostër e Planit Individual e plotësuar për nxënës në ciklin klasor 55
Shtojca 2: Mostër e Planit Individual plotësuar për nxënës në ciklin lëndor 66
Shtojca 3: Mostër e zbrazët e Planit Individual.....76
Shtojca 4: Pyetësorët për prindërit.....82
Shtojca 5: Pyetësorët për nxënësit.....88
Referencat.....94

Qëllimi i këtij udhëzuesi

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime për personat e përfshirë në hartimin e Planit Individual (PI) për nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente. Ky udhëzues është i përshtatshëm për të gjitha palët e përfshira: mësimdhënësit, prindërit, psikologun shkollor, etj.

Hyrje

Bazuar në Udhëzimin administrativ për fëmijët/ nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente (nr. 14/2019), nxënës me inteligjencë të jashtëzakonshme janë nxënësit me inteligjencë shumë më të lartë se norma e moshës së tyre (së paku 2 devijime standarde mbi mesataren, bazuar në norma ndërkombëtare). Aftësia e këtyre fëmijëve mund të shfaqet në një ose më shumë fusha sikur: krijuese, artistike, udhëheqëse, ose në një fushë specifike akademike, ndërsa;

DHUNTIA – shihet si posedim i një aftësie të jashtëzakonshme të lindur në një fushë të caktuar, që e dallon fëmijën nga bashkëmoshatarët.

TALENTI – i referohet zotërimit të një aftësie të jashtëzakonshme, të cilën individi e zhvillon në mënyrë sistematike, e njohur ndryshe si kompetencë në një fushë të caktuar, që e bën fëmijën të dallohet nga bashkëmoshatarët.

Fëmijët me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente hyjnë në grupin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të cilët kërkojnë përkujdesje dhe vëmendje të veçantë në shoqëri duke filluar nga nivelet e larta shtetërore e deri te nivelet lokale, më konkretisht nga MASHTI, DKA-të, e deri tek institucionet edukativo arsimore, mësimdhënësit, si dhe organizatat e specializuara që kanë ekspertizë në këtë fushë. Në kuadër të mbështetjes, një ndër format e përkrahjes për fëmijët me inteligjencë të

jashtëzakonshme, me dhunti e talente në nivel të institucioneve edukativo-arsimore është edhe Plani Individual, për zbatimin e të cilit obligohemi nga UA, (nr. 14/2019).

Çfarë është Plani Individual?

Plani Individual është një dokument i shkruar nga grupi punues (pjesëmarrësit e grupit punues), i përgatitur për një nxënës, i cili specifikon qëllimet mësimore që synohen të arrihen nga nxënësi gjatë një periudhe të caktuar kohore, zakonisht 1 vit shkollor. Plani individual, si një plan konciz i veprimit, bazohet në informacione nga burime të ndryshme (nxënësi, mësimdhënësit, prindërit, shkolla, apo edukatorja aty ku është e aplikueshme, etj.), të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për përkrahje, në funksion të adresimit të nevojave dhe interesimeve specifike të nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente, të cilat nuk adresohen në kuadër të procesit të rregullt edukativo-arsimor.

Kujt i dedikohet Plani Individual?

Plani Individual hartohet për secilin fëmijë, i cili përmes vlerësimit formal[1] është identifikuar me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente, e që vijon mësimet në ndonjë institucion edukativo-arsimor, publik dhe/ose privat, në të gjitha nivelet arsimore parauniversitare në Republikën e Kosovës.

[1] Me vlerësim formal nënkuptohen të gjitha llojet e vlerësimeve që përdorin teste të standardizuara e të normuara, që nënkupton procedura e administrimit është e njëjtë për të gjithë, dhe se rezultati i individit interpretohet bazuar në normat për atë grupmoshë.

Ky plan po ashtu u dedikohet edhe fëmijëve me aftësi të kufizuara (dyfish të etiketuarit)[2], të cilët kanë një dhunti apo talent në një fushë të caktuar.

Kur duhet filluar me hartimin e Planit Individual?

Pas identifikimit të fëmijës me dhunti është esenciale që sa më shpejt të fillohet me zhvillimin e PI-së, gjegjësisht, jo më larg se 30 ditë pas identifikimit të fëmijës me dhunti dhe talent/e. Koha më efikase e përpilimit të një PI është në fillim të vitit shkollor (muaji shtator), prandaj edhe rekomandohet që identifikimi i fëmijëve të bëhet në këtë kohë. Ky rekomandim jepet për arsye se zbatimi i përgjithshëm i PI-së duhet të ketë kohështrirje prej 6 deri 9 muaj të vitit (varësisht se çfarë përzgjidhet të jetë qëllimi), gjë që i jep hapësirë nxënësit të përzgjedhë qëllime më afatgjate dhe vitin shkollor ta shfrytëzoj në mënyrë efikase edhe jashtë programit të rregullt akademik.

Nëse identifikimi bëhet pas pushimeve dimërore (në pjesën e gjysmëvjetorit të dytë) nuk rekomandohet që të bëhet një plan i cili ka qëllime vjetore. Në këtë rast, ose duhet bërë një qëllim më afatshkurtër që mund të arrihet në kohë më të shkurtër (kohën e mbetur të vitit shkollor pas identifikimit), ose të zhvendoset përpilimi dhe zbatimi i planit individual për në muajin shtator të vitit tjetër shkollor.

Kush është përgjegjës për hartimin, implementimin dhe zbatimin e PI?

Përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të PI është mësuesi i klasës, respektivisht kujdestari i klasës. Ndërkaq, sa i përket implementimit,

[2] Grupi i nxënësve dyfish të etikuetuar janë ata që kanë potencial të jashtëzakonshëm intelektual por njëkohësisht kanë vështirësi në të mësuar, apo ndonjë vështirësi tjetër fizike.

është përgjegjësi e mësuesit të klasës, respektivisht kujdestarit të klasës në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit punues.

Qëllimi i planit individual

Meqenëse shkollimi i zakonshëm është i përshtatur për nevojat e fëmijëve me aftësi mesatare intelektuale, ky program shkollor nuk është i përshtatshëm edhe për fëmijët me potencial të lartë intelektual. Prandaj, duhet të pasurohet me elemente shtesë për t'i adresuar nevojat akademike dhe shoqërore të këtyre nxënësve, gjë që mund të arrihet përmes planeve individuale për fëmijët me dhunti dhe talente.

Plani individual ka për qëllim që nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente t'iu ofrojë edukim në formë akademike mundësi për zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të ndryshme, të nevojshme dhe të transferueshme për jetën e përditshme apo edhe për ndërtimin e karrierës në të ardhmen, si dhe t'i plotësojë nevojat e tyre emocionale dhe shoqërore. Plani individual përveç që u ofron atyre mundësi për t'i avancuar shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, ndikon pozitivisht në motivimin për t'u angazhuar më shumë në shkollë, gjë e cila është tejet e rëndësishme sidomos për grupin e nxënësve me dhunti me arritje nën potencial[3] të cilët janë më të rrezikuar të braktisin shkollën. Në këtë formë, plani individual shërben si mjet për t'iu mundësuar fëmijëve vit pas viti ta arrijnë potencialin e tyre intelektual të lindur.

[3] Arritja nën potencial paraqet diskrepancë në mes të performancës së pritur(potencialit) i cili matet me ndonjë test të standardizuar, dhe performancës faktike/ aktuale të dëshmuar me rezultate në teste të arritshmërisë. Persona me "arritje nën potencial" janë ata të cilët përkundër se është e vërejtshme se i zotërojnë përmbajtjet për të cilat testohen, nuk janë në gjendje të arrijnë rezultate që reflektojnë këtë, duke refuzuar të përfundojnë projektet, detyrat e shtëpisë, apo duke mos u përgatitur për orën e mësimit.

KRIJIMI I NJË VIZIONI TË PËRBASHKËT: Palët e përfshira në procesin e hartimit të Planit Individual

Pjesa vendimtare e punës në Planin Individual të një nxënësi me IJ ndodh ende pa filluar planifikimi apo implementimi i tij. Krijimi i një vizioni të përbashkët me bazë në dialogun në mes të të gjitha palëve rreth asaj se çka është më e mira për nxënësin në fjalë apo si ky nxënës mund të arrijë potencialin e tij, konsiderohet ndër faktorët determinues të zbatimit të suksesshëm të një PI. Kjo nënkupton që mësimdhënësit duhet të krijojnë raporte të ngushta me nxënësin, prindërit dhe palët e tjera të përfshira sepse pjesëmarrja aktive e të gjitha palëve rezulton në komunikim më pozitiv e proaktiv, në përcaktimin e qëllimeve të arritshme e relevante për nxënësin, si dhe rritë mundësinë e suksesit të implementimit të PI-së. Bashkëpunimi në mes të palëve duhet të tejkalojë formalitetin e plotësimit të formularëve dhe duhet parë si një nga mënyrat kryesore përmes së cilës shkolla mund të ketë ndikim pozitiv në shkollimin, rrjedhimisht edhe në jetën e nxënësit me dhunti. Ndodh që edhe grupet më të mira ndonjëherë ballafaqohen me sfida në komunikim dhe funksionim të mirëfilltë, andaj strategjitë e listuara më poshtë mund të jenë të dobishme në funksion të krijimit dhe ruajtjes se një vizioni të përbashkët:

- Krijoni një ambient miqësor ku të gjitha palët ndjehen të lira të flasin për ndjenjat e qëndrimet e tyre;
- Jini fleksibilë sa i përket përbërjes së grupit, lejoni bashkëpunimin spontan në mes të mësimdhënësve;
- Aty ku është e mundur, krijoni grupe punuese me mësimdhënës që kanë interesime të ngjashme ose që vijnë nga e njëjta fushë që të mundësohet bashkëpunimi dhe rrjetëzimi në mes të tyre;

- Krijoni mundësi që secili anëtar i përfshirë në PI të shpalos vizionin individual për nxënësin para se të vazhdohet me punën e përbashkët;
- Jini të vëmendshëm për shenjat joverbale të secilit pjesëmarrës të grupit (tonaliteti i gjuhës, gjuha trupore, shprehjet e fytyrës) dhe përshtatni komunikimin;
- Jini të vëmendshëm për ngarkesat e mundshme emocionale (shembull: prindi është shqetësuar/stresuar pasi nuk po arrihen qëllimet, nxënësi është i pakënaqur sepse nuk dëgjohet zëri i tij, ose ngarkesa të tjera që jo domosdoshmërisht lidhen me PI etj.);
- Sigurohuni që secila mbledhje në kuadër të hartimit të PI të ketë një qëllim të qartë dhe rolet e përgjegjësitë e secilit anëtar të grupit në proces të jenë të specifikuara;
- Ua rikujtoni pjesëmarrësve se përmbajtja e bisedave në takime është konfidenciale dhe nuk do ta ndani me individë të cilët nuk janë të përfshirë në një mënyrë ose tjetër në PI;
- Para secilit takim rishikoni informacionet nga pyetësorët, vëzhgimet dhe jeni të përgatitur të prezentoni para grupit;
- Nëse vëreni se ka tension në grup, bëni një pushim apo diskutoni haptas se si mund të tejkalohet situata;
- Në rast se ngecni në komunikim, mundohuni të jeni përkrahës, të bisedoni haptas për konfliktin potencial, mirëkuptoni palën tjetër dhe ia rikujtoni grupit se qëllimi i përbashkët është "arritja e rezultatit më të mirë për nxënësin";

- Krijoni programe të mentorimit në mes të mësimdhënësve, ku këta të fundit me më shumë përvojë në përpilimin e PI-ve u ndihmojnë atyre me më pak përvojë;
- Përfshini menaxhmentin e shkollës sa më shumë që të jetë e mundur pasi vetëm në këtë mënyrë do të siguroheni se PI do të implementohet në të gjithë shkollën;
- Gjatë implementimit të PI-së, mbani fokusin në arritjen e qëllimeve;
- Mbani shënime nga secili takim dhe ruani ato së bashku me të gjitha dokumentet përcjellëse[4].

Përfshirja e nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme

Hapi i parë drejt përfshirjes sa më aktive të nxënësit në Planin Individual është prezantimi i PI-së, gjatë të cilit nxënësi duhet të informohet se çfarë është një plan individual dhe për çfarë shërben ai. Nxënësi duhet t'i kuptojë e t'i shprehë nevojat dhe interesimet e tij/saj të veçanta arsimore si dhe implikimet e këtyre nevojave. Nxënësi duhet ta ketë të qartë qëllimin e PI-së, duhet t'i dijë dobitë e posedimit të tij; po ashtu, duhet të dijë se cilët janë hapat e hartimit të PI-së, kush është pjesë e grupit punues, formatin dhe të gjitha informatat e tjera të nevojshme për një Plan Individual.

Si të prezentojmë Planin Individual te nxënësi me inteligjencë të jashtëzakonshme:

[4] Formularët, pyetësorët e ndryshëm të janë përdorur për hartimin e PI-së, shënimet e nxënësit

- Filloni diskutimin mbi dallimet individuale, se si secili individ dallon për nga pamja, talentet, preferencat e madje edhe për nga mënyra e aftësia për të mësuar;
- Ndihmojeni nxënësin t'i identifikojë dhe të gjejë shembuj konkret të anëve të forta në të mësuar dhe të përshkruajë sfidat që mendon se mund t'i ketë gjatë implementimit të PI;
- Diskutoni për dobitë e planit individual;
- Kërkoni nga nxënësi të vizatojë veten dhe afër vetes të shtojë emrat e atyre që e ndihmojnë për të arritur qëllimet e specifikuara në PI, diskutoni për sistemin e përkrahjes që mund ta kenë brenda dhe jashtë shkollës

Pjesëmarrja aktive e nxënësit mund të dallojë varësisht nga mosha, motivacioni e aftësitë e tij, mirëpo parimisht vit pas viti kjo pjesëmarrje rritet.

Ofrimi i mundësisë për t'u bërë pjesë aktive e përpilimit të Planit Individual ua lehtëson këtyre nxënësve të kuptojnë më mirë veten dhe të avokojnë për nevojat e tyre të veçanta. Duke qenë pjesë e grupit i cili krijon planin individual këta nxënës kanë mundësinë të:

- të bëhen të vetëdijshëm për mënyrën e të menduarit të tyre në kontekste të ndryshme
- të bëhen përgjegjës për përvojën e tyre për të mësuar dhe për t'u angazhuar
- ofrojnë ekipit punues të dhëna për anët e forta, qëllimet, preferencat e ëndrrat e tyre

- të kuptojnë dhe të jenë në gjendje të artikulojnë nevojat e tyre specifike
- vetëdijesohen se gjërat mund të ndryshojnë me pak përpjekje
- PI ju shërben si model për të ndërtuar shkathtësitë për vetavokim
- zgjedhin, vendosin qëllime dhe të vlerësojnë veten
- rrisin nivelin e përkushtimin ndaj qëllimeve të PI dhe u jep ndjenjën e përgjegjësisë vetjake për mësim dhe angazhim
- rritë nivelin e gatishmërisë për përfshirje dhe bashkëpunim me prindërit dhe të tjerët

Përveç këtyre, të qenit pjesë e procesit të përpilimit të planit individual ua mundëson këtyre nxënësve të zhvillojnë aftësinë për metakognicion, që përshkruhet si "aftësia jonë për të ditur çfarë dimë dhe çfarë nuk dimë". Sa herë që nxënësit sfidohen me një problem, ata do të kenë nevojë të zhvillojnë strategji për t'u ballafaquar me të, andaj i gjithë ky proces përmirëson edhe aftësitë e tyre metakognitive. Metakognicioni përfshinë tri aspekte të të menduarit dhe ato janë planifikimi, monitorimi dhe vlerësimi. Kështu duke i bërë pjesë të Planit Individual ne krijojmë mundësi për zhvillimin e metakognicionit te këta nxënës.

Planifikimi si proces i të menduarit në kontekstin e PI lidhet me:

- formulimin e qëllimit
- parashikimin e rezultateve
- përzgjedhjen e veprimeve për të arritur qëllimin
- radhitjen e veprimeve
- identifikimin e sfidave potenciale

Monitorimi si proces i të menduarit në kontekstin e PI lidhet me:

- mbajtjen e fokusit në qëllim
- të qenit i vetëdijshëm për arritjen e qëllimeve afat- shkurta

- përcaktimin se kur duhet lëvizur nga një veprim te tjetri dhe përzgjedhja e veprimeve të duhura
- menaxhimin e kohës
- zbatimin e planit

Vlerësimi si proces i të menduarit në kontekstin e PI lidhet me:

- vlerësimin e arritjes së qëllimeve
- gjykimin për saktësinë e rezultateve
- vlerësimin e përshtatshmërisë së veprimit të ndërmarrë
- gjykimin efektiv të planit
- identifikimin e gabimeve dhe sfidave
- të qenit i aftë për rimëkëmbje pas dështimeve.

STRATEGJI: Si të nxisim metakognicionin te nxënësi me inteligjencë të jashtëzakonshme?

- U ofroni mundësi reale që të zgjedhin çfarë duan të mësojnë dhe si të mësojnë, pra të jenë të lirë në përzgjedhjen e asaj që duan të mësojnë
- Strukturoni aktivitetet në atë formë që nxënësi ta ketë të domosdoshme të planifikojë dhe të ndajë punën me të tjerët
- Inkurajoni nxënësin të mendoj për përvojat e tij në mësimxënie
- Inkurajoni nxënësit të identifikojnë çfarë kanë bërë me sukses dhe të përgëzohen për punën e arritur
- Inkurajoni që në vend se të thonë "Nuk mundem" të mendojnë në mënyrë proaktive "Çfarë duhet të bëjë që të arrijë këtë është...."

Nxënësit janë ata që më së miri e dinë se çfarë janë nevojat e tyre dhe duan

të jenë të suksesshëm në mësime, mirëpo për shkak se rolin e tyre shpesh e shohin si pasiv në mësim dhe mbështeten plotësisht te mësimdhënësit apo prindërit e tyre ata mund të mos kenë aftësinë e nevojshme për të artikuluar nevojat dhe kërkesat e tyre. Prandaj, për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive në PI, më poshtë listohen disa strategji të cilat mund t'ju shërbejnë mësimdhënësve e psikologut shkollor të nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësit përgjatë të gjitha fazave të PI.

STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e identifikimit të anëve të forta dhe nevojave

- Diskutoni dhe vetëdijesoni nxënësin se sa shumë kohë kalojmë duke njohur të tjerët, e sa pak kohë kalojmë për ta njohur vetën. Prandaj, u tregoni se procesi i hartimit të Planit Individual do t'ju shërbejë edhe për këtë – për ta njohur vetën më mirë.
- Ushtroni së bashku me nxënësin t'i identifikoni anët e forta të tij/saj. Fillimisht pyeteni atë për anët e forta që i ka shoku/ shoqja e tij/saj, dikush nga familjarët, ose edhe ju, dhe gradualisht kaloni në plotësimin e formularit përkatës[5].
- Inkurajojini të cekin shkathtësi në të cilat dëshirojnë të fokusohen këtë vit shkollor.
- U ofroni perspektivën tuaj të bazuar në vëzhgime rreth mënyrës si mësojnë ata më së miri, p.sh.: "Kam vërejtur se mëson më mirë nëse e lexon mësimin i pavarur."
- Prezantoni një grumbull shkathtësish, p.sh. leximi, hulumtimi, bërja e pyetjeve, zgjidhja e problemeve etj. dhe diskutoni cilat nga këto

[5] Formulari me titullin: Anët e forta

shkathtësi ju duken më të rëndësishme dhe në cilat ndjehen se do të ishin më të përkushtuar që të punojnë

STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e vendosjes së qëllimeve

- Prezentoni në vija të trasha konceptin e vendosjes së qëllimeve përmes shembujve të njerëzve me nam, duke diskutuar për arritjet e tyre
- Diskutoni për rëndësinë e vendosjes së qëllimeve. U tregoni se hulumtimet dëshmojnë që arritja e qëllimeve rritë vetëbesimin, ulë stresin dhe i bën njerëzit të ndjehen më të lumtur.
- U ndihmoni të identifikojnë qëllimet afatgjata duke i pyetur "Çfarë është suksesi për ty?", ose çfarë arritje do t'i bënte të ndiheshin krenarë me vetveten këtë vit shkollor
- Bashkoni të dhënat nga vlerësimet për të potencuar ndërlidhjen mes qëllimeve, aftësive dhe nevojave
- U ndihmoni të identifikojnë pengesat eventuale (emocionale, shëndetësore, materiale, mungesë e ndonjë shkathtësie, etj.) që mund t'i kenë gjatë rrugëtimit drejt përmbushjes së qëllimeve dhe diskutoni

  për zgjidhjet potenciale për pengesat e përmendura.

STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e implementimit të Planit Individual

- Përpiloni listëkontrollë të thjeshta që nxënësi mund t'i përdorë për të vëzhguar dhe raportuar punën e tij
- U ofroni udhëzime direkte si të avokojnë për veten, si t'i kërkojnë gjërat që ju nevojiten, si të diskutojnë me mësimdhënësit për detyra alternative
- Inkurajoni nxënësin më të rritur që ta zhvillojë i pavarur planin e veprimit drejt realizimit të qëllimeve dhe ta monitorojë vetveten (qoftë qëllime që janë pjesë e IP apo qëllime të tjera domethënëse për ata).

STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë pjesëmarrjen e nxënësit në fazën e rishikimit të Planit Individual

- Ndani kohë në takimet rregullta të PI kur nxënësit mund të raportojnë për progresin e tyre
- Inkurajoni nxënësin që të përdorë listëkontrollë për të monitoruar progresin e tij
- Bëni një kornizë për gjërat që duhet të raportojë nxënësi.

Përfshirja e prindërve

Roli i prindit në raport me zhvillimin e kësaj kategorie të nxënësve potencohet në Udhëzimin administrativ, UA 14/2019, për fëmijët/ nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme,dhunti e talente në udhëzuesin e të cilit thuhet *"Prindi/ kujdestari në mënyrë individuale konsultohet dhe*

bashkëpunon me mësimdhënësit dhe stafin profesional të shkollës për predispozitat, shenjat dalluese që i shfaq fëmija i tij në faza të ndryshme gjatë rritjes dhe zhvillimit, me qëllim të identifikimit, vlerësimit dhe mbështetjes së arritjes së potencialit të plotë të fëmijës." Prindërit kanë njohuri specifike dhe esenciale për fëmijët e tyre. Ata janë mësimdhënësit e parë të tyre dhe kanë qenë të pranishëm në kontekste të ndryshme të jetës së fëmijës, përtej shkollës. Njohuritë e shumta që ata kanë për fëmijët e tyre shërbejnë si bazë për procesin e përpilimit të Planit Individual. Përveç kësaj, hulumtimet tregojnë se prindërit të cilët kuptojnë filozofinë e shkollës, njohin stafin shkollor dhe janë pjesë aktive e procesit mësimor janë më të kënaqur me nivelin e edukimit që u ofrohet fëmijëve të tyre. Prindërit kanë nevojë për mundësi reale të pjesëmarrjes në shkollimin e fëmijëve të tyre. Ata shpesh duan të jenë të përfshirë në vendimmarrje, të kenë qasje në informacion dhe të kenë mundësi të japin idetë e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Të gjithë prindërit kanë prioritete për fëmijët e tyre dhe këto mund të jenë të ndryshme nga prioritetet e mësimdhënësve apo të nxënësit. Perspektivës së prindit duhet t'i jepet vëmendje dhe të shqyrtohet paralel me prioritetet e fëmijës dhe mësimdhënësve ashtu që përmes bashkëpunimit të arrihet marrja e vendimeve në favor të nxënësit. Prindërit mund të kyçen në procesin e përpilimit të Planit Individual në të gjitha fazat e tij.

Prindërit mund të ofrojnë informacione lidhur me:

- anët e forta dhe dobësitë (aspektet që kanë nevojë për përmirësim)
- historinë familjare (aspekti socio-ekonomik, dinamikat familjare, etj.) dhe atë të edukimit që mund të ndikojnë në të tashmen te fëmija
- historikun mjekësor dhe nevojat specifike shëndetësore
- tiparet e personalitetit

- interesimet, talentet, dëshirat
- synimet dhe pritjet e familjes për fëmijën
- përkrahjen që mund të ofrojnë prindërit për të promovuar mësimin dhe zhvillimin e shkathtësive të ndryshme
- informacionet për shërbimet e komunitetit, aktivitetet pas shkollës apo çfarëdo specifike që mund të ndikojë në procesin mësimor.

Por, arritja e bashkëpunimit me prindërit nuk është gjithmonë gjë e lehtë, pasi që shumë prindër mund të ndihen jo komod në ambiente formale shkollore, sidomos në takimin e parë. Ndonjëherë kur sjellja e fëmijës është sfiduese, problematike apo kur ballafaqohen me situata të jashtëzakonshme, prindërit mund të manifestojnë brengën dhe kujdesin për fëmijën e tyre edhe përmes tensionit, ankthit, frustrimit apo ikjes. Është e rëndësishme që mësimdhënësit të mos paragjykojnë dhe të mos bëjnë supozime të bazuara në sjelljet e prindërve, pasi që sjelljet e tyre jo gjithmonë reflektojnë se si ata vërtetë ndihen, por mund të jenë mekanizma mbrojtës të vet atyre. Mësimdhënësit duhet të kenë parasysh se shumë prindër nuk kanë informacion për shkollën/ procesin mësimor apo punën në shkollë. Gjithashtu barrierat e ndryshme emocionale mund të jenë ato të cilat pamundësojnë krijimin e një atmosfere bashkëpunuese. Disa nga këto barriera përshijnë:

- prindërit të cilët si fëmijë kanë pasur probleme me shkollimin: ata mund të ndihen jo komod të punojnë me mësimdhënësit
- ndjenja të fajit se janë përgjegjës për vështirësitë me të cilat fëmijët e tyre ballafaqohen
- disa familjeve iu nevojitet kohë të kuptojnë se fëmijët e tyre kanë nevoja specifike

- situata familjare të cilat pamundësojnë pjesëmarrjen e prindërve në mbledhje, si të qenit prind i vetëm, orari i punës, anëtarët tjerë të familjes për të cilët duhet ofruar përkujdesje, etj.
- besimet kulturore se shkolla dhe shtëpia janë dy aspekte të ndara
- probleme me besimin: u duhet shumë punë për të ndërtuar besim
- dyshim në aftësitë e shkollës për të ofruar shërbime adekuate përkrahëse.

Sigurimi i përfshirjes së prindërve kërkon kohë, besim dhe krijim të idesë te prindërit se ata janë partnerë shumë të rëndësishëm në procesin e planifikimit. Mësimdhënësit mund të kenë një rol udhëzues, sidomos në fillimet e procesit të planifikimit, ashtu që të sigurohen prindërit se kjo vërtetë është një mundësi për t'u bërë pjesë aktive e shkollimit të fëmijëve të tyre. Mësimdhënësit duhet t'i bëjnë prindërit që të kuptojnë rolin dhe vlerën e Planit Individual dhe kontributit që ata mund të japin në këtë proces. Më poshtë përshkruhen strategji që mund t'ju shërbejnë mësimdhënësve dhe psikologut shkollor të sigurojnë bashkëpunim me prindërit dhe të tejkalojnë konfliktet potenciale
gjatë procsit të hartimit të PI-së.

STRATEGJI: Si të arrijmë të sigurojmë bashkëpunimin me prindërit

- Organizoni takimet me prindërit në orar dhe ambient të përshtatshëm për të dyja palët
- Keni parasysh nivelin e edukimit të prindërve kur caktoni sa anëtarë të stafit do të jenë pjesëmarrës në mbledhje (nëse niveli i edukimit të prindërve është elementar, takimi me më shumë se një mësimdhënës mund të duket sfidues dhe t'i bëjë të ndjehen jo rehat)

- Ua dërgoni agjendën e takimit, një apo dy ditë paraprakisht. Kjo do të mundësojë që ata të mendojnë për temat që do të diskutohen në takim dhe të reflektojnë e përgatiten për takimin.
- Mendoni për informatat që mund të ofrojnë prindërit. Merrni parasysh pyetjet sikur:

– A ka pasur ndryshime në familje që do të donit t'i ndanit me ne (anëtar i ri në familje, ndryshim i orarit të punës, aktivitete të reja jashtë shkollore)?

– A ka ndonjë përkrahje shtesë për fëmijën (kurs privat, kohë me një të rritur mentor, apo nxënës më të rritur)?.

- Inkurajoni prindërit të përpilojnë pyetje për të cilat dëshirojnë të kenë përgjigje
- Organizoni sallën e takimit në atë mënyrë që promovon bashkëpunim (ulja në rreth, apo tavolinat rrethore promovojnë bashkëpunimin)
- Çmoni informacionin që prindërit ndajnë me ju dhe u lejoni kohë të mjaftueshme gjatë mbledhjeve për reflektim e diskutim.

STRATEGJI: Si të tejkalojmë konfliktet dhe të zgjidhim problemet me prindërit

- Theksoni se interesimet e fëmijës janë gjithmonë preokupimi juaj primar
- Dëshmoni se jeni të motivuar për të zgjidhur problemet dhe argumentoni se kjo është për të mirën e fëmijës (p.sh, " Vlerësoj gatishmërinë tuaj për..." apo "Jam i gatshëm të përkushtohem për hartimin e një plani që do të funksionojë për të gjithë").

- Trajtoni çështjet specifike të prezentuara
- Fokusohuni në përmbajtje të PI-së dhe jo në emocionet apo personalitetet e personave të përfshirë
- U ofroni atyre mundësinë që të japin mendimin e tyre për situatën në fjalë
- Sigurohuni se jeni duke kuptuar mirë perspektivën e tyre: shumë herë konflikti lind pikërisht si rezultat i keqkuptimeve, andaj gjithmonë sqaroni problemin para se të ofroni zgjidhje
- Sigurohuni që pritjet tuaja janë të arsyeshme dhe në përputhje me mundësitë
- Në mënyrë eksplicite theksoni se ju jeni të përkushtuar në realizimin e Planit Individual.

Përfshirja e stafit shkollor (drejtorit, psikologut të shkollës/pedagogut, etj.)

Siç u përmend edhe në fillim të kësaj kaptine bashkëpunimi është çelësi i suksesit. Bashkëpunimi në kontekstin e hartimit dhe implementimit të PI parashihet të realizohet brenda niveleve, e institucioneve të ndryshme. Përveç mësimdhënësve, nxënësit dhe prindërve, varësisht nga natyra e interesimeve e qëllimeve të nxënësit, në grupin punues mund të përfshihen individë të ndryshëm brenda e jashtë shkollës si psikologu i shkollës, koordinatorët e ndryshëm, stafi tjetër përcjellës, drejtori i shkollës, mësimdhënës të jashtëm, individë të cilët punojnë me nxënësin jashtë shkollës apo individë të cilët mund të ofrojnë informacione shtesë lidhur me aftësitë, shkathtësitë, nevojat apo interesimet e nxënësit me IJ. Bashkëpunimi mundëson shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës, të cilat si rezultat avancojnë njohuritë e ekipit punues dhe e ndihmojnë grupin punues të:

- njohin më mirë nxënësin (përmes vëzhgimeve në klasë, raportet që ka me bashkëmoshatarët, faza e zhvillimit në të cilën është, informata nga vlerësimet, artikulimi, etj.)
- identifikojnë mënyra si të adresojmë më së miri nevojat e tij
- aplikojnë metodologji të përshtatshme të mësimit
- rrisin kohën e dhënies së udhëzimeve për nxënësin
- shfrytëzojnë resurset e përbashkëta
- konsultohen rreth vendimmarrjes
- ndajnë përgjegjësinë lidhur me implementimin e PI
- rrisin komunikimin dhe konsistencën e implementimit të PI

Drejtori i shkollës bazuar në Udhëzimin administrativ për fëmijët/ nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti dhe talente (nr. 14/2019), në emër të institucionit edukativo-arsimor ka për detyrë të sigurohet se fëmijët me IJ,dhunti e talente janë pjesë e planifikimeve në kuadër të planit zhvillimor të institucionit, planeve vjetore dhe periodike të aktiviteteve. Përkitazi me hartimin dhe zbatimin e PI-së drejtori i shkollës duhet të:

- sigurojë që për secilin nxënës të identifikuar me IJ, dhunti e talente në shkollën të cilën e drejton ai të hartohet, implementohet e monitorohet PI;
- identifikojë mësimdhënësin i cili është bartës kryesor i PI (mësimdhënësi i klasës në ciklin klasor, ose kujdestari i klasës në ciklin lëndor);
- sigurojë që stafi mbështetës profesional (psikologu i shkollës, pedagogu) të jetë i përfshirë në grupin punues;
- ofrojë grupit punues mundësinë për konsultim e këshillim në rast nevoje;

- ofrojë përkrahje maksimale qoftë në formë të burimeve në dispozicion, shërbimeve, informacioneve.

Në anën tjetër, **mësuesi i klasës**, respektivisht **kujdestari i klasës**:

- është përgjegjës të iniciojë hartimin e PI për nxënësin e identifikuar në klasën e tij;
- është përgjegjës për hartimin, implementimin, monitorimin e PI në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të grupit punues;
- lehtëson komunikimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë brenda grupit;
- kërkon ndihmë, udhëzime apo vlerësime shtesë nga anëtarët e tjerë të grupit;
- konstaton anët e forta dhe nevojat e nxënësit përmes vëzhgimit, vlerësimeve formale dhe jo formale (në bashkëpunim me grupin punues);
- zhvillon strategji që mundësojnë integrimin e qëllimeve e objektivave përfundimtare në aktivitetet në klasë;
- sigurohet që PI të përmbajë informacionet e domosdoshme që lehtësojnë implementimin;
- mbikëqyrë dhe raporton në bazë të rregullt për progresin e nxënësit si dhe adapton apo modifikon aktivitetet, rutinën, teknikat e mësimdhënies apo objektivat në përputhje me situatën.

Përfshirja e **psikologut shkollor** si hallkë në zinxhirin e bashkëpunimit mësimdhënës-prind, është e domosdoshme gjatë procesit të hartimit dhe implementimit të PI. Psikologu i shkollës në përputhje me shumë nga pikat e Udhëzimit administrativ nr. 34/2014 për funksionimin e shërbimit pedagogjik dhe psikologjik në shkolla ka këto përgjegjësi:

- kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënit dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve;
- ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- bashkëpunon me profesionistë të tjerë dhe zbaton vlerësime të përshtatshme (të besueshme dhe valide);
- zhvillon intervista me nxënës, mësimdhënës e prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme me qëllim të vlerësimit objektiv dhe propozon e zbaton masa për intervenime psiko-edukative individuale dhe në grup;
- punon me nxënës për të zhvilluar strategji efektive të të nxënit, të zhvillimit social e personal, strategji vet-monitoruese e shkathtësi tjera kognitive;
- identifikon dhe vlerëson nevojat e nxënësve;
- zhvillon këshillime individuale dhe/ ose grupore që përqendrohen në funksionimin e shëndetshëm të nxënësit; ndihmon në përgatitjen e planit individual mësimor të fëmijës.

Përgjegjësitë e lartpërmendura lidhen në mënyrë direkte apo indirekte edhe me procesin e hartimit dhe implementimit të PI.

Gjatë hartimit dhe implementimit të PI, **psikologu i shkollës** me theks të veçantë:

- lehtëson komunikimin prind-mësimdhënës, prind-nxënës, dhe mësimdhënës-nxënës;
- këshillon palët në punën e tyre me nxënësin me dhunti brenda dhe jashtë klasës.

- interpreton të dhënat nga pyetësorët e ndryshëm dhe ndihmon grupin punues në identifikimin e anëve të forta dhe nevojave specifike të nxënësit;
- asiston në formulimin e qëllimeve të PI, veçanërisht atyre të natyrës psiko-sociale;
- angazhohet të identifikojë sfidat e mundshme individuale të nxënësit (motivimi i ulët, perfeksionimi, ankthi për arritje, etj.) në implementimin e PI dhe e ndihmon nxënësin me IJ t'i tejkalojë ato.

Përfshirja e individëve jashtë shkollës

Anëtarë të ndryshëm nga komuniteti të cilët punojnë me nxënësin jashtë shkollës mund të kenë informata të vlefshme lidhur me interesimet, anët e forta dhe nevojat e nxënësit me IJ, dhunti e talente, andaj përfshirja e tyre në grupin punues mund të jetë me dobi. Këta individë mund të jenë trajnerë ekipesh sporti, punonjës të qëndrimeve ditore, mësimdhënës nga ndonjë aktivitet jashtëshkollor, ekspert të fushave të ndryshme, etj.

PROCESI NËPËR TË CILIN KALON PLANI INDIVIDUAL: nga hartimi deri te zbatimi

Hartimi i PI-së është dydimensional dhe përfshin **procesin**, me të cilin nënkuptohet bashkëpunimi në mes të prindërve dhe shkollës, dhe **strukturën**, që ndërlidhet me identifikimin e anëve të forta, nevojave dhe planifikimin e objektivave afatshkurta dhe qëllimeve afatgjata etj.

Në kuadër të këtij procesi është e rëndësishme që të mbahen takime të rregullta[6] që nga fillimi i hartimit të planit e deri në përfundim të implementimit të tij. Prandaj, meqë takimet mund të kenë funksion të ndryshëm varësisht kur ndodhin gjatë procesit, ato ndahen në dy tipe:

I. **Takimet planifikuese** - Takimet planifikuese zakonisht janë 2-3 takimet e para. Ato shërbejnë për të diskutuar lidhur me interesimet e nxënësit për fushat dhe temat e caktuara si dhe për t'u njoftuar palët bashkëpunuese me strukturën dhe procesin e zbatimit të PI-së. Gjatë këtyre takimeve, shtjellohet dhe përkufizohet qëllimi vjetor i PI-së dhe vendosen objektivat me qëllim të përmbushjes së tij. Gjithashtu, në këtë fazë, plotësohet edhe forma e PI-së me të gjitha pjesët e saj, gjë që është shumë e rëndësishme për faktin që PI përmban të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me faktorët fuqizues në përmbushjen e qëllimit vjetor të PI-së, por edhe

[6] Shpeshtësia e takimeve gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të PI varet në masë të madhe nga lloji i qëllimit dhe karakteristikat e nxënësit, megjithatë **Takimet Planifikuese** duhet të përfundojnë në afat prej 30 ditësh nga inicimi i procesit. Në kontekstin e fazave këtu përshihen fazat 1-3, ndërkaq sa i përket shpeshtësisë së **Takimeve Monitoruese** ato nuk mund të jenë më të rralla se një here në muaj dhe përfshijnë fazat 4-6.

identifikon paraprakisht nevojat e nxënësit dhe sfidat e mundshme në procesin e implementimit.

II. **Takimet monitoruese** – Takimet monitoruese shërbejnë për të vëzhguar procesin e mbarëvajtjes së zbatimit të PI-së. Gjatë këtyre takimeve mbikëqyret niveli i zbatimit të planit, arritja e objektivave të paracaktuara, diskutohet për sfidat eventuale që shfaqen gjatë procesit si dhe ofrohen zgjidhje në funksion të vazhdimit të implementimit të PI në raste kur PI nuk është duke u implementuar sipas planifikimit.

Gjashtë fazat e procesit të realizimit të PI-së janë:

1. Identifikimi i nevojave
2. Vendosja e orientimit/ drejtimit (Çfarë duam të arrijmë me këtë plan)
3. Përpilimi i planit
4. Implementimi i planit
5. Rishikimi dhe rishqyrtimi
6. Planifikimi për tranzicion.

1. Identifikimi i nevojave

Gjatë takimeve planifikuese nxënësi dhe prindërit do të inkurajohen nga mësimdhënësi që të shpalosin interesimet e nxënësit. Përveç interesimeve është e rëndësishme të identifikohen anët e forta dhe nevojat komplekse të nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti e talente qofshin ato akademike, psikologjike apo sociale. Një qasje e tillë e cila shkon përtej aspektit akademik mundëson që nxënësi të zhvillojë shkathtësi të reja që

janë të transferueshme në fusha të ndryshme dhe të ngrisë vetbesimin i cili është i domosdoshëm për një funksionim të mirëfilltë qoftë në aspektin akademik apo psikologjik.

Gjatë procesit të identifikimit të nevojave duhet marrë për bazë pyetjet në vijim:

- Çfarë anë të forta, talente shfaqë ky nxënës?
- Çfarë është duke ndodhur aktualisht në programin akademik të këtij nxënësi?
- Pse ka ardhur deri tek identifikimi i këtij nxënësi?
- Çfarë modifikimesh (nëse duhen bërë) arsimore, sociale, infrastrukturore etj, janë të nevojshme apo të mirëseardhura në mënyrë që ky nxënës t'i arrijë qëllimet e PI-së?
- Çfarë informatash tjera janë të nevojshme për të kuptuar më gjerësisht këtë nxënës (në aspektin psikologjik, social, etj.)
- Çfarë na tregojnë interesimet specifike të këtij nxënësi dhe arritjet e tij aktuale për nevojat e tij?

Nevojat e nxënësve mund të mos jenë të përfshira në planprogram shkollor, prandaj është e domosdoshme që edhe ato që nuk janë të përfshira në planprogram, të identifikohen dhe të adresohen përmes PI-së. Në këto raste, nxënësit i ofrohen shërbime jashtë sistemit shkollor ose nëse shkolla nuk mund të ofrojë shërbime shtesë, së paku duhet ofruar fleksibilitet që nxënësi të arrijë plotësimin e nevojave akademike.

Për shumë nxënës që janë me IJ, dhunti e talente nevojat e tyre burojnë nga karakteristikat e tyre. Ato përbëjnë një "shtojcë" të një karakteristike të shprehur për të cilën duhet modifikuar diçka, ashtu që të zhvillohet në

mënyrë adekuate për t'i shërbyer përmbushjes së nevojave dhe interesimeve të tij.

Lista e mëposhtme paraqet karakteristika të këtyre nxënësve dhe si ato shndërrohen në formë të nevojave. Mësimdhënësit mund të përdorin këto informacione si pikënisje për përpilimin e PI-ve, apo për identifikimin e ndryshimeve të nevojshme në funksion të përmbushjes së nevojave të atij nxënësi.

Karakteristikat e nxënësit:	**Nevojat mësimore:**
kujtesë e jashtëzakonshme	ekspozim ndaj më shumë materialeve/ informacioneve
të kuptuar të avancuar	qasje në aktivitete sfiduese të mësimit
interesime të llojllojshme	ekspozim me tema të llojllojshme
aftësi superiore verbale	mundësi për reflektim dhe diskutime të thella
përpunim i shpejt	përshpejtim i të mësuarit
fleksibilitet në të menduar	detyra sfiduese, dhe të llojeve të ndryshme, që kërkojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve
i motivuar për punë	kohështrirje më të gjatë për punë
i pavarur në mësim	më shumë detyra individuale/

	pavarësi në punë
mendim analitik	mundësi për nivele më të larta të të menduarit
ndjeshmëri emocionale	mundësi për të reflektuar e eksploruar ndjenjat dhe për të mësuar menaxhimin e tyre
interesime përtej moshës	ekspozim ndaj problemeve reale
lexues i pasionuar	qasje në literaturë të llojllojshme e të avancuar

2. Vendosja e drejtimit/ orientimit-Çfarë duam të arrijmë me këtë plan

Pyetja kryesore që parashtrohet gjatë vendosjes së drejtimit është: Çfarë duam të arrijmë më këtë plan? Së bashku në grup punues përcaktimi i prioriteteve ndihmon ekipin mësimor të fokusohet në atë çfarë është kritike apo kyçe që nxënësi të arrijë brenda vitit shkollor. Ekipi i përcakton këto prioritete duke u bazuar në të gjitha informatat të cilat janë mbledhur deri në atë ditë. Për t'i përcaktuar nevojat më të rëndësishme të të mësuarit, prindërit mund të punojnë me ekipin mësimor për t'i shqyrtuar këto çështje:

- Identifikimin e fushave prioritare në të cilat duhet fokusuar
- Mundësinë për t'i përdorur shkathtësitë apo njohuritë e fituara nga PI, në fushat e tjera tematike, apo kushte të tjera
- Ndërlidhjen e fushave ku nxënësi ka anë të forta
- Ndikimin e nevojave specifike të nxënësit në të mësuarit e përgjithshëm dhe arritjet

- Kontributin në aspektin e pavarësimit të përgjithshëm të nxënësit
- Përputhshmërinë me moshën kronologjike
- Kohën e nevojshme për zotërimin e kësaj shkathtësie të re
- Ndërlidhjen e shkathtësive dhe njohurive me qëllimet e nxënësit në të ardhmen.

3. Përpilimi i planit

Pas takimeve të para ku identifikohen anët e forta, nevojat dhe prioritetet e nxënësit fillohet me përpilimin e planit. Plani duhet të përpilohet nga grupi i përfshirë (i specifikuar më lartë), ku nxënësi duhet të ketë rolin kyç në ofrimin e informacioneve mbi interesat e tij/saj, ndërsa të tjerët mbështesin me informacione dhe të dhëna shtesë mbi anët e forta dhe nevojat e nxënësit, formulimin e qëllimeve dhe zbërthimin e tij në hapa konkret, etj.

Sa i përket informacioneve që nevojiten për plotësimin e PI-së, janë draftuar disa pyetësorë [7] të cilët u jepen për plotësim nxënësit, prindit dhe mësimdhënësit për të identifikuar të dy anët e forta dhe nevojat e nxënësit, si ato në përgjithësi, aq më tepër ato që ndërlidhen drejtpërdrejtë me përcaktimin dhe formulimin e qëllimit të PI-së.

P.sh. nëse një fëmijë i klasës së tretë ka interesim për t'i avancuar njohuritë mbi astronominë, mund të caktohet një qëllim i cili i përket fushës së astronomisë i cili është i pëlqyeshëm për nxënësin, por që është i arritshëm për një vit shkollor. Një qëllim të tillë mund ta përkufizojmë në këtë mënyrë:

[7] Pyetësorët për grumbullimin e të dhënave për nxënësin janë të bashkëngjitura në këtë udhëzues.

- Joni, deri në fund të vitit shkollor (10 qershor) do të ketë të njohur sistemin solar dhe galaktikat më të njohura të gjithësisë.

Për të arritur qëllimin e përcaktuar më lartë deri në fund të vitit shkollor, Joni duhet të kalojë nëpër disa hapa konkret. Prandaj, qëllimi duhet të zbërthehet në disa objektiva afatshkurta të matshme (2 deri 4 max.) dhe të definuara në kohë, të cilat na sigurojnë që nëse Joni kalon nëpër to, ai do të arrijë qëllimin përfundimtar. Disa nga objektivat e mundshme janë:

a) *Deri më 15 nëntor, Joni do të përgatisë një punim (3-4 faqe) lidhur me sistemin solar ku do t'i specifikojë planetet me elementet e tyre dalluese.*
b) *Deri më 15 shkurt Joni do t'i identifikojë 3 galaksitë me të njohura dhe do të përshkruajë strukturën dhe karakteristikat e tyre.*
c) *Deri më 31 maj, Joni do të bëjë prezentimin e sistemit solar dhe 3 galaksive para nxënësve të klasës (ose klasave të treta).*

Në Planin Individual, ky qëllim me këto objektiva do të duket në këtë formë:

Qëllimi: *Joni, deri në fund të vitit shkollor (10 qershor) do të ketë të njohur sistemin solar dhe 3 galaksitë më të njohura të gjithësisë.*
Objektivat:

a) Deri më 15 nëntor, Joni do të përgatisë një punim (3-4 faqe) lidhur me sistemin solar ku do t'i specifikojë planetët dhe specifikat e tyre.	*b) Deri më 15 shkurt Joni do t'i identifikojë 3 galaktika më të njohura dhe do ta përshkruajë strukturën dhe karakteristikat e tyre.*	c) *Deri më 31 maj, Joni do të bëjë prezentimin e sistemit solar dhe 3 galaktika para nxënësve të klasës (ose klasave të treta).*

Procesi i përpilimit nënkupton edhe plotësimin e pjesëve të tjera të PI, siç janë pikat e takimit fillestar, të dhënat nga vlerësimet, anët e forta, nevojat e nxënësit, akomodimet dhe strategjitë, etj. (Si plotësohen këto rubrika dhe çfarë informacione duhen përfshirë në to do të shtjellohet në detaje në kapitullin 4. Brenda planit individual

4. Implementimi i PI-së

Në këtë fazë, ekipi punues rishikon përmbajtjen e PI-së dhe vendosë si do të matet progresi. Këtu mësimdhënësve u takon të krijojnë një llojllojshmëri strategjish e praktikash të vlerësimit varësisht nga lloji i qëllimit afatgjatë. Pra, kërkohet të mbahen takime të rregullta monitoruese. Padyshim që edhe prindërit dhe të tjerët mund të asistojnë në këtë proces në kontekstet e tjera ku mësimdhënësi nuk mund të vëzhgojë sjelljen. Në momentin që PI

finalizohet, ekipi duhet të mobilizohet për të mundësuar që objektivat dhe qëllimet e parashtruara të arrihen. Pikat në vazhdim duhet të merren parasysh gjatë implementimit të PI-së:

- sigurohuni që mënyra të cilën keni vendosur për të vlerësuar progresin është në përputhje me objektivat dhe qëllimet e paracaktuara
- integroni ndryshimet e nevojshme në ligjërim dhe aktivitetet e tjera në klasë
- krijoni mundësi për mësim të udhëhequr nga vet fëmija duke lejuar fleksibilitet në orë të mësimit
- rishikoni objektivat dhe praktikat sa herë që është e nevojshme
- bëni intervenime në mjedis ashtu që të promovoni angazhim dhe pjesëmarrje aktive.

Si anëtar i ekipit mësimor të fëmijës së tyre, prindërit mund të kenë rol aktiv në procesin e implementimit. Një mënyrë e rëndësishme e përfshirjes së prindërve është në përforcimin e shkathtësive dhe strategjive në kontekstin jashtëshkollor. Kur prindërit e kuptojnë se cilat janë qëllimet afatgjata dhe objektivat afatshkurtra në planin e fëmijës së tyre, ata mund të vendosin se si më së miri t'i mbështesin fëmijët e tyre në shtëpi.

5. Rishikimi dhe rishqyrtimi i Planit Individual

Rishikimi dhe rishqyrtimi periodik[8] i PI është i rëndësishëm për t'u siguruar që jemi në drejtimin e duhur për t'i arritur qëllimet e parashikuara me PI sepse gjatë implementimit të planit mund të shfaqen sfida të paparashikuara ose të krijohen kushte të cilat mund të vështirësojnë arritjen e qëllimeve. Nganjëherë, për arsye të caktuara, mund të ndodhë që nxënësi dhe mësimdhënësi të dakordohen edhe për ndryshimin e qëllimit. Kjo nuk duhet të jetë synim dhe as të bëhet praktikë, por nganjëherë shkaqet që sjellin deri tek ky vendim janë pamundësia për të vazhduar me qëllimin e vendosur për shkak të shëndetit, shpërnguljes, ndonjë ngjarje të papritur, etj.

PI është dokument i cili zhvillohet dhe modifikohet në vazhdimësi varësisht nga nevojat e nxënësit. Në këtë kontekst gjatë rishikimit dhe rishqyrtimit:

Objektivat ose qëllimet mund të:

• shtohen—ashtu që fëmija të sfidohet dhe të përfitojë mjaftueshëm

• zvogëlohen—nëse kushtet kanë ndryshuar dhe objektivat e parashtruara nuk janë relevante

• ndryshohen/ zëvendësohen—nëse qëllimi është arritur shumë shpejt, apo më nuk është relevant për fëmijën .

[8] Së paku 3 herë gjatë një viti shkollor në përputhje me planifikimet vjetore të shkollës lidhur me vlerësimet (p.sh në përfundim të secilës periodë). Nëse qëllimi është më afatshkurtër pasi nxënësi është identifikuar pas pushimeve dimërore, rishikimi bëhet së paku 1 herë. Rishikimi mund të bëhet në çdo kohë me kërkesën e cilësdo palë, sipas nevojës.

6. Planifikimi për tranzicion

Nëse një fëmijë është duke kaluar nga cikli klasor në atë lëndor, drejtori i shkollës është i obliguar t'i informojë mësimdhënësit lidhur me kapacitetin e lartë intelektual të nxënësit, duke i obliguar ata që të kenë parasysh nevojat për angazhim shtesë në mësimdhënie sidomos në fushat prioritare të interesimeve të nxënësit. Gjithashtu, kujdestari i klasës është ai i cili tani merr përsipër angazhimin për krijimin e grupit punues për hartimin dhe zbatimin e PI-së. Mësuesi/ja i/e nxënësit duhet ta informojë kujdestarin mbi ecurinë e mësimnxënies që ka pasur nxënësi gjatë nivelit 1-5, duke theksuar angazhimet e tij si në kuadër të procesit të rregullt mësimor dhe ato ekstrakurrikulare. Po ashtu, mësuesi/ja në mënyrë të detajuar njofton kujdestarin/en e klasës për anët e forta dhe nevojat që nxënësi ka shfaqur gjatë mësimit.

I njëjti rregull vlen edhe nëse nxënësi e ndërron shkollën për çfarëdo arsye. Drejtori i shkollës në bashkëpunim me mësuesin apo kujdestarin e klasës obligohen që nxënësin ta pajisin me një raport të shkurtër lidhur me karakteristikat e tij, anët e forta e nevojat e demonstruara, përmbledhje të aktiviteteve kyçe ku ka qenë pjesëmarrës e ndër të tjera të ceken edhe qëllimet e PI-ve të viteve të kaluara.

BRENDA PLANIT INDIVIDUAL

1. Informata për nxënësin

Të dhënat demografike për nxënësin jepen në rubrikën e parë të PI-së. Këto të dhëna përfshijnë të dhëna bazë siç janë emri dhe mbiemri, klasa të cilën vijon nxënësi, etj.

2. Informata paraprake: Konteksti shkollor dhe përfshirja e prindërve

Në rubrikën "**konteksti shkollor"** shënohen informacionet për shkollën ku nxënësi vijon mësimet, ndërkaq në rubrikën "**përfshirja e prindërve"** shënohen datat e takimeve si dhe çfarë është arritur gjatë takimeve të mbajtura: interesimet që janë shprehur nga nxënësi, prindërit dhe vet mësimdhënësi, fusha se ku do të fokusohet PI, si dhe shpeshtësia e takimeve (sa herë në javë apo muaj do të mbahen takimet e përbashkëta).

3. Identifikimi i anëve të forta

Në rubrikën "**anët e forta" ,** përfshihen shkathtësi dhe fusha të veprimtarisë ku nxënësi dallohet për performancë më të lartë dhe më cilësore se mesatarja, ose ndonjë karakteristikë që e veçon atë nxënës. Anët e forta mund të jenë të fushave të ndryshme sikur shkathtësitë sociale, shkathtësitë organizative, stili i të nxënit, apo procesimi kognitiv. Informacionet për anët e forta mund të merren nga pyetësorët të cilët shpërndahen dhe plotësohen paraprakisht (para fillimit të përpilimit të PI-së) nga nxënësi, prindi/kujdestari ligjor, mësimdhënësit, si dhe nga vëzhgimet e nxënësit nga mësimdhënësit apo edhe psikologu i shkollës gjatë procesit shkollor.

Informacione të tilla mund të jenë:

- Oratori e zhvilluar;
- Memorie afatgjatë;
- Aftësi të të mësurit vizuele-pamore;
- Preferon punën individuale;
- Është bashkëpunëtor;
- Është kreativ;
- Ka muzikalitet të shprehur;
- Preferon të zgjidhë situata problemore;
- Është i mirë në menaxhimin e kohës;
- Ka sens të lidershipit.

Në këtë rubrikë është gjithashtu e përshtatshme të përfshihen informacione sikur:

- karakteristikat individuale që ndihmojnë të mësuarit (motivacioni, gatishmëria për bashkëpunim);
- interesimet apo dëshirat;
- arritjet jo-akademike;

SHEMBULL: Anët e forta

- *Pëlqen të shoqërohet dhe të bashkëpunojë me nxënësit e tjerë;*
- *Ka sens humori dhe pëlqehet nga të tjerët;*
- *I pëlqen të ndërtojë gjëra, posaçërisht në shkencë;*
- *I shkathët në punën në kompjuter, gjen faqe nga më interesantet në internet;*
- *Shkëlqen në sporte;*
- *Ka vesh muzikor, etj.*
- *Është këmbëngulës dhe i përkushtuar në atë çfarë i pëlqen;*
- *Ka interesim dhe njohuri të shumta në fushën e astronomisë, etj.*

4. Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për përkrahje

Ekipi punues duhet të përdorë informacione nga burime të ndryshme, siç janë të dhënat nga vlerësimet dhe niveli aktual i performancës për të identifikuar nevojat e nxënësit. Përshkrimi në rubrikën "**identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për përkrahje"** duhet të ndërlidhë të dhënat nga vlerësimet formale me fushat specifike sikur:

- mangësi në ndonjë fushë/ aspekt specifik që e pengon apo vështirëson të mësuarit p.sh në aspektin social, emocional, të vëmendjes, etj.;
- aftësi akademike p.sh., në sferat si analizë e përmbajtjeve, të shprehurit me shkrim ose me gojë, etj.;

SHEMBULL: Nevojat për përkrahje

- *Strategji për të përmirësuar të kuptuarit e përmbajtjeve, me fokus në shkencat sociale*
- *Strategji për planifikim, shkrim dhe korrigjim - me qëllim të përmirësimit të cilësisë së të shprehurit me shkrim*
- *Strategji për të zvogëluar ankthin lidhur me situatat testuese*

5. Aspektet shëndetësore që ndikojnë në mësim

Kjo rubrikë e PI-së duhet të përfshijë çdo informatë të rëndësishme shëndetësore e cila mund të ndikojë në mësim. P.sh. mund të përfshijë përmbledhje të raportit që konfirmon një diagnozë të ADHD-së (definim i shkurtër) dhe që jep indikacione se ai nxënës mund të jetë me ndonjë terapi ditore. Ose, nxënësi mund të ketë epilepsi apo ndonjë sëmundje tjetër. Në këto raste duhet shmangur aktivitete të cilat mund të nxisin sulmin epileptik apo të ndikojnë negativisht në gjendjen shëndetësore të tij. Në këto raste,

shënohet diagnoza e nxënësit dhe merret parasysh si për planifikimin e qëllimit, ashtu edhe për vendosjen e objektivave. Natyrisht, vetëm informacione mjekësore të ndërlidhura drejtpërdrejtë me nevojat e të nxënit të nxënësit duhet të përfshihen në PI (Plani Individual).

Jini të kujdesshëm kur ndani informacionet e diagnozave apo në përgjithësi gjendjet e shëndetit mendor dhe si i vendosni ato në dokumentin e PI-së!

Disa nxënës mund të mos jenë në dijeni për gjendjen e tyre, apo nuk janë në gjendje t'i kuptojnë diagnozat e tyre për çfarëdo arsye (mosha, ndjeshmëria emocionale, rrethi familjar, etj.) por, megjithatë, ata ende mund të kenë aftësi për të kuptuar nevojat e tyre individuale. Në qoftë se nxënësi nuk ka vështirësi shëndetësore relevante për zbatimin e PI-së, është e rëndësishme të shënohet që: "Nxënësi nuk ka vështirësi shëndetësore të njohura deri me këtë ditë." Te rubrika ngjitur, ***Personi ndihmës*** shkruani emrin e personit i cili e ndihmon nxënësin nëse ka ndonjë diagnozë shëndetësore.

6. Të dhënat nga vlerësimet formale

Informacioni i vlerësimit i shënuar në këtë rubrikë të PI-së duhet të ndërlidhet drejtpërdrejtë me nevojat e jashtëzakonshme të të nxënit të nxënësit, si dhe me llojet e programimit dhe mbështetjes së kërkuar. Vlerësimet formale në aspektin kognitiv për nxënësin me IJ, dhunti e talente në përgjithësi vijnë nga psikologët shkollorë dhe institucionet e specializuara që merren me këtë kategori të fëmijëve. Burime të tjera të vlerësimeve mund të jenë testet e standardizuara, apo garat e fushave si gjuhë dhe komunikim, shkenca, arte, sporte, teknologji etj. Këtu duhen prezentuar të dhënat nga vlerësimet e dy viteve të fundit. Çdo vlerësim

formal duhet të listohet në PI dhe duhet të përfshijë datën, mjetin (formën) e vlerësimit, institucionin, apo emrin e personit i cili ka bërë vlerësimin dhe rezultatin. Kur të dhënat e vlerësimit të plotësohen, është e rëndësishme të tregoni kujdes me ndarjen e informacioneve specifike lidhur me IQ dhe llojet tjera të vlerësimeve. Gjatë raportimit të rezultateve nga testet e IQ-së identifikoni vetëm nivelin e rezultatit (p.sh. mesatar, mesatare e lartë, superior, shumë superior) e assesi numrin e saktë, ndërsa në fushat e tjera raportoni përqindjen nga totali, apo shkruani vendi i parë, vendi i dytë etj).

7. Niveli aktual i performancës dhe arritjeve

Niveli aktual i performancës nënkupton të gjitha vlerësimet formale të performancës së nxënësit në një ose më shumë fusha të cilat ndërlidhen me qëllimet e PI-së. Gjatë punës suaj si mësimdhënës duhet *të jeni të kujdesshëm gjatë interpretimit të rezultateve të arritjes bazuar në nivelin klasor meqenëse testet në fushat tematike nuk janë të dizajnuara për të vlerësuar njohuritë jashtë nivelit të klasës.* Kjo rubrikë duhet gjithashtu t'i përfshijë edhe përmbledhjet e vlerësimeve të rëndësishme klasore, siç janë: mostrat e shkrimeve, vlerësimet e të arriturave matematikore, portfoliot, punimet artistike dhe kreative, si dhe vëzhgimet e mësimdhënësve dhe të nxënësit që lidhen drejtpërdrejtë me qëllimet e PI-së.

8. Qëllimi afatgjatë dhe objektivat afatshkurta

Qëllimi dhe objektivat janë thelbi i çdo Plani Individual dhe shërbejnë si bazament për vendimmarrje përgjatë gjithë procesit. Plani Individual për nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, dhunti e talente duhet të ketë

së paku një qëllim afatgjatë[9] për nxënësit që janë në klasat 1-3, ose 1-2 qëllime për nxënësit më të rritur (kl. 4-12). Secili qëllim duhet të ketë 2 deri në 4 objektiva. Rubrikat **"qëllimi afatgjatë"** dhe "**objektivat afatshkurta"** duhet të plotësohen gjatë fazës së përpilimit të PI-së nga grupi punues dhe përmbajtja e tyre duhet të ketë për bazë informacionet nga pyetësorët e plotësuar nga nxënësi :***Pyetësori i interesimeve të nxënësit***, ***Pyetësori për mënyrën e preferuar të mësimit*** dhe pyetësorët e plotësuar nga prindërit ***Vendosja e qëllimeve nga familja*** dhe ***7 Pyetjet.*** Meqenëse qëllimet dhe objektivat bazohen në nevojat dhe interesimet individuale të nxënësit me IJ, me dhunti, e talente ato dallojnë nga një nxënës te tjetri varësisht nga niveli aktual i performancës, interesimet, specifikat psikosociale të tij, konteksti familjar dhe planet e tij për të ardhmen. Pra, qëllimet dhe objektivat duhet të jenë të veçanta për secilin nxënës me IJ, me dhunti, e talente dhe assesi nuk duhet të përpilohen të njëjtat qëllime për më tepër se një nxënës.

Para se të diskutojmë për llojet e qëllimeve dhe objektivave, ato duhet të plotësojnë këto parakushte për të qenë funksionale në një PI.

Modeli **SMART** është mënyrë e mirë për të menduar për qëllimet dhe objektivat. Sipas këtijë modeli ato duhet të jenë:

Specifike – të përdoret gjuhë koncize që mundëson të kuptojmë çfarë pritet që fëmija të arrijë kur qëllimi të jetë realizuar.
Matshme – të specifikohet qartë çfarë shkathtësie, aftësie do të përvetësohet dhe në çfarë niveli, ashtu që i gjithë grupi punues të mund të vlerësojë se a është arritur qëllimi apo objektiva specifike

[9] 6 deri 9 muaj të vitit (varësisht se çfarë përzgjidhet të jetë qëllimi)

Arritshme – të kenë parasysh nivelin aktual të nxënësit dhe të jenë realiste për të.

Relevante – të reflektojnë interesimet dhe nevojat e nxënësit dhe të jenë mjaftueshëm sfiduese (jo shumë lehtë të realizueshme, por as shumë të vështira sa që bëhen të paarritshme).

Të definuara në kohë – të kenë një afat kohor brenda të cilit duhet të arrihen.

Si rregull i parë, i ikni përdorimit të përgjithësuar të gjuhës në formulimin e qëllimeve dhe objektivave, MOS shkruani:

- do të përmirësojë të kuptuarit
- do të ketë ngritje të vetëbesimit
- do të përmirësojë të lexuarit
- do të avancojë njohuritë

pasi formulime të tilla mund të interpretohen në mënyra të ndryshme nga individë të ndryshëm, gjë e cila paraqet problem në rastin kur duam të vlerësojmë nëse nxënësi ka arritur objektivën apo jo, p.sh.: nëse qëllimi është formuluar “do ta përmirësojë të lexuarit”, çfarë është nënkuptuar me këtë? A konsiderohet përmirësim leximi i saktë i fjalëve, intonacioni, rrjedhshmëria apo të gjitha. Për të hartuar qëllime e objektiva specifike mund të përdoret lista e mëposhtme e kompetencave, por jo vetëm:

Të aftësohet	Të klasifikojë	Të përshkruaj	Të vizatojë	Të ilustrojë
Të analizojë	Të krahasojë	Të dizajnoj	Të shpjegoj	Të nisë (bisedë, aktivitet)
Të zbatojë	Të kopjojë	Të përcaktojë	Të shprehë	Të ndërveprojë
Të aplikojë	Të numërojë	Të zhvillojë	Të përcjellë, respektojë (udhëzime)	Të listojë
Të aranzhojë	Të krijojë	Të dallojë	Të gjeneralizojë	Të lokalizojë
Të vlerësoj	Të vendosë	Të diskutojë	Të ofrojë	Të ndërtojë
Të llogarisë	Të definojë	Të marrë pjesë	Të grupojë	Të parashikojë
Të zgjedhë	Të demonstrojë	Të hulumtojë	Të identifikojë/ njohë	Të përgatisë
Të propozojë	Të lexojë	Të reagoj përshtatshëm	Të recitojë	Të ndërlidhë
Të ndajë	Të zgjidhë	Të shkruaj	Të verbalizojë	Të përdorë

Kur flasim për qëllime dhe objektiva të matshme nënkuptohet se ato duhet të ngërthejnë në vete informacion që na mundëson të vlerësojmë/gjykojmë për arritjen e tyre. Dy mënyrat si qëllimi dhe objektivat bëhen të matshme janë duke përcaktuar:

numrin apo përqindjen e herave që duhet demonstruar sjellja apo shkathtësia, shembull:

Ari do të lexojë rrjedhshëm 5 paragrafë.
Diella do të zgjidhë 20 detyra...
Flaka do të recitojë 5 vjersha 2 strofëshe.
Ylli do të përdorë 10 koncepte të mësuara në shkrimin e një eseje.
Erea do të përgatisë 2 prezantime për ...
Kreshniku do të marrë pjesë në 90 % të diskutimeve për ...

dhe nivelin e pritur e saktësisë së demonstrimit të sjelljes, shembull:
Ari do të lexojë rrjedhshëm 5 nga 7 paragrafet.
Diella do të zgjidhë saktë 20 nga 25 detyrat.
Flaka do të recitojë 5 nga 6 vjershat dystrofëshe.
Ylli do të përdorë 10 nga 15 konceptet e mësuara për të shkruar një ese.

Llojet e qëllimeve

Varësisht nga nxënësi për të cilin punohet PI, qëllimet mund të jenë të llojeve të ndryshme e të fokusuara në fusha të ndryshme. Qëllimet mund të ndërlidhen me:

- shprehitë e punës
- aftësitë dhe shkathtësi akademike (leximi, shkrimi, llogaritja)
- shkathtësitë vet-ndihmuese
- shkathtësitë bazë (komunikimi, sjellja në klasë, shkathtësitë motorike, shkathtësitë kompjuterike, etj.)
- shkathtësitë për jetën (shkathtësi të cilat e ndihmojnë nxënësin të jetë më i pavarur)

Kur kombinojmë të gjitha që janë shtjelluar deri më tani, pra të qenit specifik, të matshëm, me ndonjë nga fushat e mundshme, qëllimet mund të duken kështu, p.sh.:

- Deri më (datën), (emri i nxënësit) **do të aftësohet rreth** përdorimit të programeve kompjuterike Ëord dhe Excel **duke krijuar** 4 dokumente në prani të mësimdhënësit.
  Deri më (datën), (emri) **do të ngrisë** aftësitë në fushën e llogaritjeve në matematikë për 30% nga rezultati i tanishëm.
  Deri më (datën), (emri) **do të pasurojë** fjalorin për 100 fjalë.
  Deri më (datën), (emri) **do të formulojë** 5 hipoteza për hulumtim për temën...
  Deri më (datën), (emri) **do të mendojë** në nivele më të larta, të dëshmuara me punime në klasë ku përdoret analiza dhe sinteza.
  Deri me (datën), (emri) **do të demonstrojë** rritje prej 10-15% në aftësitë udhëheqëse të cilat do të maten me një listë kontrollë nga mësimdhënësi.
  Deri më (datën), (emri) **do të bashkëpunojë** në mënyrë të suksesshme 2 nga 3 herët në punime grupore, të evidentuara nga vëzhgimet e mësimdhënësit.

9. Procedurat e vlerësimit

Secila objektivë duhet të ketë qartë të definuar procedurën e vlerësimit apo "si do ta dimë nëse nxënësi ka arritur objektivën në fjalë". Varësisht nga lloji i objektivave mësimdhënësit mund të përdorin procedurat e vlerësimit

në vijim, por jo vetëm:

- vëzhgimin e sjelljes/ veprimit, ku hyjnë ekzekutimi i ndonjë veprimi në një program kompjuterik, punë në program kompjuterik apo teknologji të tjera, performanca në një instrument muzikor, recitimi, leximi, aktrimi, të folurit publik apo shkathtësi të tjera që janë të verifikueshme përmes vëzhgimit;
- mostra të punës, këto mund të jenë mostra të shkrimit, detyra të shtëpisë, punime artistike apo punime të tjera;
- test me shkrim ose verbal;
- listë kontrollë të gabimeve siç janë diktimet, leximet, apo detyrave të përfunduara me sukses, etj.

Edhe pse procedurat e vlerësimit mund të jenë të llojllojshme, ato kanë një gjë të përbashkët, secila ka kriterin e kalueshmërisë. Po ashtu, kur mendoni se cila procedurë e vlerësimit është më e përshtatshme për objektiven, keni parasysh edhe preferencat e nxënësit të deklaruara në formularët ***Preferencat në të mësuar*** dhe ***Pyetësori për mënyrën e preferuar të mësimit***. Nëse keni vendosur se mënyra më e mirë për të vlerësuar arritjen e një objektive është **testi me shkrim**, mendoni se çfarë tipi i testit është më i përshtatshëm për objektivën në fjalë: sa pyetje duhet t'i ketë ai test, çfarë lloj pyetjesh na tregojnë më së miri për arritjet e nxënësit, ato me opsione të shumëfishta, pyetjet saktë-pasaktë, pyetjet e hapura të cilat kërkojnë nga nxënësi që të përgjigjet shkurtimisht me fjalë, apo një kombinim i pyetjeve. Mendoni edhe për kriterin e kalueshmërisë, në sa nga pyetjet e parashtruara duhet nxënësi të përgjigjet saktë, në mënyrë që të mund të konstatojmë se objektiva është arritur. **Kriteri i kalueshmërisë preferohet të jetë 80%** pasi nën këtë përqindje nuk konsiderohet se nxënësi ka zotëruar apo

zhvilluar në nivel superior përmbajtjet apo shkathtësitë e synuara.

Në rastin e qëllimit të shtjelluar te **Implementimi i Planit** - *Joni, deri në fund të vitit shkollor (10 qershor) do të ketë të njohur sistemin diellor dhe 3 galaksitë më të njohura të gjithësisë.*

Procedura e vlerësimit do të mund të dukej kështu:

- Një punim njëfaqësh me nga një paragraf për secilin prej elementeve
të objektivave.

- 20 pyetje të mbyllura me opsione të shumëfishta lidhur me temën, me nivel kalueshmërie 80%, pra 16 nga 20 pyetjet nxënësi duhet të përgjigjet saktë.

- Prezentim prej 10 sllajdeve për temën, ku shtjellohen të gjithë nëntitujt dhe po ashtu përmban përmbajtje grafike në 5 nga 10 sllajde.

10. Rishikimi i progresit

Rishikimi i progresit duhet të bëhet për secilën nga objektivat e përcaktuara. Rishikimi mund të bëhet në baza mujore nga grupi punues, mirëpo plotësimi formal i rubrikës **"rishikimi i progresit"** bëhet vetëm gjatë rishqyrtimit periodik, pra së paku 3 herë gjatë një viti shkollor në përputhje me planifikimet vjetore të shkollës. Rishikimi i progresit duhet të plotësohet nga nxënësi në bashkëpunim me mësuesin apo kujdestarin e klasës. Në këtë

rubrikë duhet treguar qartë statusin e progresit në raport me objektivën e parashtruar. Tipet e statuseve mund të jenë:

- i papërfunduar,
- në proces e sipër,
- i përfunduar.

Krahas statusit duhet përshkruar shkurtimisht arsyet prapa statusit specifik, shembull:
- i pa përfunduar pasi objektiva ka qenë vështirë e realizueshme për shkak të rrethanave,
- i papërfunduar për shkak të gjendjes shëndetësore,
- i përfunduar me sukses, tani Joni njeh sistemin diellor dhe 3 galaksitë kryesore, etj.

11. Përmbledhja e fundvitit

Qëllimi i përmbledhjes së fundvitit është për t'u siguruar që nxënësi të vazhdojë të punojë edhe më tutje në realizimin e qëllimeve dhe që ai, bashkë me grupin punues, të reflektojë për këtë vit shkollor. Mënyra se si zakonisht e bëjmë një përmbledhje të tillë është përmes bashkëbisedimit me nxënësin dhe prindin lidhur me ecurinë e PI-së të vitit aktual, si dhe aspiratat për vitin vijues. Në këtë rubrikë konsideroni pyetjet e hapura si këto në vijim:

- Cilat janë arritjet dhe pikat kyçe të suksesit për këtë vit?
- Çfarë ka shkuar mirë?
- Çfarë s'ka qenë efektive?
- Cilat qëllime kërkojnë përqendrim të vazhdueshëm vitin që vjen?

- Cilat qëllime të reja duhet të hulumtohen për vitin tjetër?

Përmbledhja e fundvitit mund të plotësohet nga nxënësi, apo mund të jetë kontribut i përbashkët i mësimdhënësve, nxënësit, prindërve dhe psikologut të shkollës.

12. Akomodimet dhe strategjitë për të përkrahur arritjen e qëllimit

Akomodimet e nevojshme për të mundësuar arritjen e qëllimeve duhen listuar në rubrikën **"akomodimet dhe strategjitë"** brenda Planit Individual. Me akomodim nënkuptojmë çfarëdo ndryshimi nga forma e rregullt e mësimit, detyrave apo pjesëmarrjes në aktivitete brenda klasës të nxënësit. Në akomodime përfshihen: strategji specifike të mësimdhënies apo vlerësimit si dhe përdorimi i pajisjeve specifike të cilat promovojnë mësimin tek ai nxënës. **Qëllimi i akomodimeve** është ofrimi i mundësive të barabarta me nxënësit e tjerë që edhe këta të mund të jenë të suksesshëm.

Shembuj të akomodimeve janë:

- ndërrimi i vendit brenda klasës (ulja me ndonjë nxënës që shërben si model për shkathtësitë që nxënësi dëshiron të zhvillojë, apo larg nga dikush qe e pengon në orën e mësimit),
- modifikimi i materialeve për mësim (ofrimi i më shumë materialeve se për të tjerët, përmbajtje më sfiduese, kapërcim i përmbajtjeve tashmë të zotëruara, etj.),
- lirimi nga një orë mësimore ku nxënësi është i avancuar dhe ndjekja e orës në fushën e interesimit në klasa më të larta,
- sigurimi i një kabineti punues në orar të caktuar,
- sigurimi i një laptopi apo programi kompjuterik, etj.

Përzgjedhja e duhur e akomodimeve të nevojshme duhet të ketë parasysh përgjigjet në pyetjet:

- Çfarë e bën më të lehtë mësimin apo punën për këtë nxënës?
- Çfarë deklaron nxënësi se i ndihmon për të mësuar, apo për të demonstruar njohuritë e fituara?
- Çfarë thonë prindërit për mënyrën si mëson ai në shtëpi?
- Çfarë e pengon këtë nxënës të shfaqë aftësitë e shkathtësitë e fituara?

Të dhëna lidhur me pyetjet paraprake mund t'i grumbulloni përmes përdorimit të formularëve: ***Preferencat në të mësuar***, ***Pyetësori për mënyrën e preferuar të mësimit***, ***Sfidat në të mësuar*** dhe ***Pyetësori i Prindërve.***

Ekzistojnë 3 lloje të akomodimeve:

a) **akomodime mjedisore:** mundësi për lëvizje në klasë, ndryshim i vendit, leje për të punuar i pavarur jashtë klasës apo edhe shkollës, etj.
b) **akomodime në ligjërim**: ofrimi i materialeve shtesë, ofrimi i formave alternative të shpjegimit, pyetje që përkojnë me nivele më të larta sipas taksonomisë së Bloom-it, etj.
c) **akomodime në vlerësim:** mundësi për të përzgjedhur formën e preferuar dhe më të përshtatshme për vlerësim.

Akomodimet mund t'u ofrojnë nxënësve me IJ, dhunti e talente mundësinë të hulumtojnë koncepte, marrin pjesë në aktivitete në klasë, të dëshmojnë për njohuritë e tyre në përputhje me aftësitë dhe

nevojat e tyre specifike. Mësimdhënësit luajnë rol të rëndësishëm në këtë pikë, pasi që pa iniciativën dhe angazhimin e tyre nuk mund të identifikohen e aplikohen këto akomodime.

13. Informacione shtesë

Në rubrikën **"informacione shtesë"** mund të përmenden informata të tjera që janë relevante për nxënësin, e që mund të ndikojnë në implementimin e Planit Individual, por që nuk mund të përfshihen në rubrikat tjera. Informacionet shtesë mund t'i identifikoni nga pyetësorët ***Pyetësori i interesimeve të nxënësit***, dhe ***Pyetësori për prindërit*** si dhe nga bashkëbisedimi i lirë me prindërit dhe nxënësin në kuadër të takimeve planifikuese.
Informacione shtesë mund të jenë gjendja socio-ekonomike e nxënësit, situata në shtëpi, aktivitetet jashtëshkollore, etj.

Shembull: nëse bashkërisht me nxënësin keni caktuar një qëllim i cili ka implikime financiare e familja nuk qëndron mirë financiarisht, kjo mund të përmendet në këtë rubrikë pasi është relevante dhe mund të ndikojë negativisht në arritjen e qëllimit.

Shembull: nëse në kohën kur është duke u realizuar PI, nxënësi është i angazhuar në gara jashtë shkollës (jo të përfshira në PI), kjo duhet të përmendet në këtë rubrikë sepse mund të ndodhë që nxënësi mund të mos jetë i motivuar apo mund të mos ketë kohë të mjaftueshme për të punuar në PI.

14. Nënshkrimet

Para se të fillojë së zbatuari, secili Plan Individual e ka të domosdoshëm ta ketë:

- miratimin e prindit/ kujdestarit ligjor, në formë të nënshkrimit në fund të planit;
- nënshkrimin e mësuesit apo kujdestarit të klasës;
- nënshkrimin e psikologut të shkollës;
- nënshkrimin e drejtorit të shkollës .

Nënshkrimet duhet të vendosen në rubrikën përkatëse në PI dhe duhet të jenë plotësuar në momentin që plani individual është zhvilluar dhe është i gatshëm për implementim.

Si të veprohet në raste kur prindi refuzon ta nënshkruajë PI-në?

Në rastin kur prindi refuzon ta nënshkruajë PI për shkak se nuk pajtohet me qëllimet e caktuara nga shkolla, grupi punues obligohet që t'ia ofrojë një mundësi të fundit prindërve të diskutojnë për çfarëdo ndryshimi eventual apo paqartësie lidhur me planin. Nëse edhe pas këtij takimi prindi refuzon ta nënshkruajë PI-në, atëherë përkrahja e nxënësit duhet të realizohet përmes formave të tjera të pasurimit duke u bazuar në UA 14/2019.
Në rast se prindi e ka nënshkruar PI-në, por nuk ka qenë bashkëpunues që nga fillimi i procesit, duke mos qenë pjesë e takimeve për hartimin e PI-së, atëherë qëllimet duhet përpiluar në atë mënyrë që të jenë të realizueshme në kontekstin shkollor.

Për të parë një Plan Individual të plotësuar në tërësi, shikoni mostrat në Shtojcën 1 dhe 2 në fund të këtij udhëzuesi. Ndërkaq, formën e zbrazët të PI (të cilën mund ta kopjoni) e gjeni në Shtojcën 3.

Shtojca 1: Mostër e Planit Individual e plotësuar për nxënës në ciklin klasor

PLAN INDIVIDUAL

PËR NXËNËS ME INTELIGJENCË TË JASHTËZAKONSHME, DHUNTI E TALENTE

Informata për nxënësin

Emri dhe mbiemri: Arta N.
Data e lindjes: 17.02.2013
Mosha: 7.5 vjeç

Klasa: III
Prindërit: N.N dhe N.N

E-mail:

Tel:

Adresa:

Informata paraprake: Konteksti shkollor

Shkolla: "N.N"
Mësuesi/ja apo kujdestari/ja i/e klasës: N.N
Mësimdhënësit e tjerë të përfshirë në realizimin e PI-së: Mësimdhënësi i edukatës fizike

Psikologu i shkollës: N.N
Palë të tjera jashtë shkollës: Trajneri i gjimnastikës, N.N

Informata paraprake: Përfshirja e prindërve dhe nxënësit

Me datën 12 shtator kemi pasur një takim bashkëpunues me prindër, ku kemi biseduar për testin e inteligjencës që i është bërë vajzës së tyre dhe për fillimin e hartimit të PI për të. Takimi është mbajtur në zyrën për takime me prindër brenda objektit shkollor. Në takim informova prindërit për anëtarët që do të jenë pjesë e grupit bashkëpunues dhe rolin e tyre në dhënien e kontributit që nxënësja të arrijë qëllimin e përcaktuar me PI. Prindërit morën formularët e pyetësorëve për karakteristikat e fëmijës që t'i plotësojnë.

Më 18 shtator: Realizuam një takim tjetër të karakterit social. Në këtë takim palët e përfshira ishin: nxënësja, mësuesja, prindërit, psikologia e shkollës dhe zv. drejtoresha. Takimin e realizuam në sallën e edukatës fizike ku Arta u ndje e lirë në shprehjen e interesimeve se çfarë dëshiron të arrijë gjatë një viti shkollor krahas mësimit të rregullt.

Arta: Kam dëshirë të kyçem më shumë në fushën e Gjimnastikës sportive dhe ritmike. Më së shumti më pëlqejnë ushtrimet akrobatikë.

Prindërit e Artës: Arta ka shumë sens edhe për gjuhë shqipe dhe letërsi, por ne jemi shumë të kënaqur me përzgjedhjen e fushës së interesimit nga ana e vajzës tonë. Gjithashtu, mendojmë që ka nevojë të ngritë vetëbesimin në shoqërim me të tjerët.

Më 23 shtator: U mbajt takimi i tretë, pjesë e të cilit ishin: Arta, prindërit, mësuesja, psikologia e shkollës dhe grupit punues iu bashkëngjit mësimdhënësi i edukatës fizike dhe trajneri i klubit të gjimnastikës. Në këtë takim u vendosen qëllimi afatgjatë dhe objektivat afatshkurtra të PI-së. U punuan edhe pjesët tjera të PI-së.

Në këtë takim vendosëm që shpeshtësia e takimeve të jetë një herë në muaj (të enjteve të fundit të çdo muaji) ku do të mblidhet grupi bashkëpunues për të diskutuar përkitazi me monitorimin e mbarëvajtjes së PI-së. Në këtë takim po ashtu u vendos që të fillojë implementimi i PI-së që nga 1 tetori.

Për të gjitha takimet e realizuara u mbajtën shënime.

Anët e forta	***Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për përkrahje***
- Ambicioze - Këmbëngulëse në arritjen e qëllimit - E motivuar dhe me plot vetëbesim - Aftësi gjuhësore dhe shkathtësi komunikuese - Shkathtësi në fushën Edukatë fizike, sportive - Shkathtësi në fushën e arteve - Art pamor - Aftësi të ndërlidhjes së suksesshme të njohurive paraprake me ato të reja - Mendje-hapur	- Të arrijë rezultate më të mira në përsosjen e shkathtësive të lëvizjes sipas ritmit. - Të pranoj kritikën si diçka pozitive për të. - Të ngrisë nivelin e durimit. - Të orientohet dhe inkurajohet që të eksperimentojë në fushën e saj të interesimit.
Aspekte shëndetësore që ndikojnë në mësim	***Personi ndihmës***
Nxënësja nuk ka vështirësi shëndetësore të njohura deri me sot.	Nuk ka nevojë

Të dhëna nga vlerësimet formale

Testi	**Data e testimit**	**Institucioni**	**Rezultati**
Stanford–Binet Intelligence Scale: Fifth Edition	Shtator 2017	Instituti ATOMI	Superiore

Garat e diturisë në gjuhë shqipe në nivel shkollor	Mars 2017	Shkolla “N.N”	Vendi i parë Arritje 100 %

Niveli aktual i performancës	*Përfundimi i vitit shkollor*
Suksesi në periodën e parë ose periodën e dytë (shkruaj notat nga lëndët që janë relevante me qëllimet e PI) Gjuhë shqipe: 5 Gjuhë angleze: 5 Edukatë muzikore: 5 Edukatë figurative : 5 Matematikë: 5 Njeriu dhe natyra: 5 Shoqëria dhe mjedisi: 5 Edukatë fizike: 5 Shkathtësi për jetë: 5 Mësim zgjedhor: 5 *Lëndët e preferuara:* Edukatë fizike dhe gjuhë shqipe	*Suksesi në periodën e tretë* Gjuhë shqipe: 5 Gjuhë angleze: 5 Edukatë muzikore: 5 Edukatë figurative : 5 Matematikë: 5 Njeriu dhe natyra: 5 Shoqëria dhe mjedisi: 5 Edukatë fizike: 5 Shkathtësi për jetë: 5 Mësim zgjedhor: 5

Përmbledhja e fundvitit

Shkathtësitë formuese (p.sh komunikimi, sjelljet e përshtatshme në klasë, motorikë)

Qëllimet e arritura: ■ të gjitha ❑ shumica prej tyre ❑ disa

Shkathtësi të përgjithshme (p.sh shkathtësi të cilat do ta ndihmojnë nxënësin të jetë i pavarur në shkollë, shtëpi dhe komunitet)

Qëllimet e arritura: ■ të gjitha ❑ shumica prej tyre ❑ disa

Çfarë janë arritjet për këtë vit shkollor? *Demonstron koordinim në kryerjen e kombinacioneve gjimnastikore me përmbajtje të elementëve akrobatike. Menaxhon më mirë emocionet e tij/saj dhe i përshtatë ato në situata të ndryshme.*

Çfarë ka funksionuar? *Ushtrimet e shpeshta dhe angazhimi i ekipit punues në kërkim të zgjidhjeve kur janë shfaqur sfidat ka qenë shumë motivuese për nxënësen. Përkushtimi i saj ka dhënë rezultate të larta.*

Çfarë nuk ishte efektive? *Pamundësia e përdorimit të rekuizitave të ndryshme për akrobacion. Është dashur të kërkohet leje nëpër salla sportive në shkolla tjera ku ka rekuizita të nevojshme për realizim të programit të planifikuar.*

Në çfarë duhet fokusuar vitin tjetër? *Fokusi për vitin tjetër - përveç ushtrimeve akrobatike që do të shkojnë në nivel më të lartë, do të jetë edhe në vallëzimet ritmike-(baleti).*

Çfarë qëllime duhen hulumtuar vitin tjetër? *Arta shpreh interesim për vitin e ardhshëm të merr pjesë në gara kombëtare të gjimnastikës dhe të renditet sa më lartë në shkallën e suksesit. Megjithatë, qëllimi do të formulohet vitin që vjen, ne fillim të muajit shtator.*

Qëllimi afatgjatë: Deri në fund të vitit shkollor (qershor 2018) nxënësja Arta do t'i përvetësojë teknikat akrobatike – gjimnastikë të nivelit të dytë (forca, baraspesha dhe fleksibiliteti) dhe do të përgatisë një pikë

gjimnastikore për programin për ditën e shkollës.		
Objektivat afatshkurta	***Procedurat e vlerësimit***	Rishikimi i progresit
1. Deri në fund të dhjetorit 2018, nxënësja duhet të mësoj rregullat e ushtrimeve gjimnastikore dhe të jetë në gjendje të demonstrojë kapërcimin fluturimthi dhe urën para trajnerit.	Vlerësim me shkrim me 10 pyetje lidhur me rregullat e ushtrimeve gjimnastikore. Kriteri i kalueshmërisë 8 të sakta nga 10 total. Realizimi i suksesshëm i kapërcimit fluturimthi dhe urës 5 herë	Kam përfunduar me sukses testin për rregullat e ushtrimeve akrobatike të përgatitura nga mësuesja dhe mësimdhënësi i lëndës së edukatës fizike. Gjithashtu edhe demonstrimin e ushtrimeve e kam bërë me sukses.
2. Deri në fund të muajit mars Arta duhet të jetë në gjendje të demonstrojë para grupit: Kërcim i kaluçit me këmbë të hapura anash dhe me këmbë të mbledhura.	Realizim i suksesshëm në kapërcimin kaluçit me këmbë të hapura anash dhe me këmbë të mbledhura ku përfshihen të gjitha hapat për ekzekutim të veprimit. Kriteri i kalueshmërisë: ekzekutimi i 80% të lëvizjeve në mënyrë të saktë.	Kam realizuar me sukses 50% të veprimeve, andaj kam nevojë për më shumë kohë dhe ushtrime për ta realizuar këtë objektivë.

3. Deri në fund të majit Arta duhet të demonstrojë ecje mbi tra me kthim prapa nga qëndrimi këmbe mbledhur me kërcim me trup në hark.	Realizim i suksesshëm të ecjes mbi tra me kthim prapa nga qëndrimi këmbe-mbledhur me kërcim me trup në hark ku përfshihen të gjitha hapat për ekzekutim të veprimit. Kriteri i kalueshmërisë: ekzekutimi i 80% të lëvizjeve në mënyrë të saktë.	Kam realizuar me sukses 90% të veprimeve.
4. Deri me 10 qershor, Arta do t'i integroj të gjitha lëvizjet akrobatike në një pikë për programin shkollor.	Realizimi i suksesshëm i të gjitha lëvizjeve akrobatike gjatë dy provave gjenerale para programit shkollor. Kriteri i kalueshmërisë: realizimi i të gjitha lëvizjeve akrobatike me jo më tepër se 2 gabime gjatë performancës.	Kam realizuar provat me vetëm një gabim gjatë performancës.
Qëllimi afatgjatë:		
Objektivat afatshkurta	***Procedurat e vlerësimit***	Rishikimi i progresit
1.		
2.		

3.		
4.		

Akomodimet dhe strategjitë për të përkrahur arritjen e qëllimit
- Lirimi i herëpashershëm (sipas nevojës) nga orët e Gjuhës shqipe dhe të Edukatës muzikore që nxënësja të jetë prezentë në orët e Edukatës fizike në një klasë tjetër më lartë e nganjëherë edhe në nivelin e mesëm të ulët (në bashkëpunim me mësimdhënësit). - Ofrimi i mundësisë së shfrytëzimit të sallës së Edukatës fizike edhe jashtë orarit mësimor. - Ofrimi i mundësisë për të ndarë përvojat e saj me bashkëmoshatarët edhe jashtë klasës. - Marrëveshja me trajnerin e klubit të gjimnastikës që dy herë në muaj të merr pjesë në klubin e gjimnastikës me nxënësit më të rritur. - Klubi i gjimnastikës do të mundësojë vizitë në Parkun e Aventurave në Pejë.
Informacione shtesë
- Gjatë muajit mars, Arta do të udhëtojë jashtë vendit me prindërit e saj për një periudhë dy javore prandaj duhet të bëhet zgjidhje për kompensimin e orëve të humbura. - Menaxhmenti i shkollës do të përpiqet të mundësoj demonstrime të aktiviteteve akrobatike edhe në shkolla tjera.
Nënshkrimet
I kam të qarta dhe pajtohem me informatat e përfshira në këtë plan

individual

X

Prindi

X

Drejtori i shkollës

X

Mësuesi apo Kujdestari i klasës

X

Psikologu i shkollës

Shtojca 2: Mostër e Planit Individual e plotësuar për nxënës në ciklin lëndor

PLAN INDIVIDUAL
PËR NXËNËS ME INTELIGJENCË TË JASHTËZAKONSHME, DHUNTI E TALENTE

Informata për nxënësin

Emri dhe mbiemri: Nart N.
Data e lindjes: 02.05.2008
Mosha: 11 vjeçar
Klasa: VI
Prindërit: N.N dhe N.N

E-mail:
Tel:
Adresa:

Informata paraprake: Konteksti shkollor

Shkolla: "N.N"
Mësuesi/sja apo kujdestari/ja i/e klasës: N.N
Mësimdhënësit e tjerë të përfshirë në realizimin e PI-së: N.N dhe N.N

Psikologu i shkollës: N.N
Palë të tjera jashtë shkollës: N.N.

Informata paraprake: Përfshirja e prindërve dhe nxënësit

Në muajin shtator kemi organizuar një takim informues. Takimi është mbajtur me datën 20.09.2019 në objektin e shkollës. Në këtë takim morën pjesë ekipi i shkollës, prindi dhe nxënësi. Në këtë takim, nxënësin dhe prindin i njoftuam për inicimin e hartimit të një PI për Nartin. Gjatë takimit u dakorduam që bashkëpunimi ynë të jetë i vazhdueshëm dhe të gjitha palët e përfshira në këtë plan, të kontribuojnë maksimalisht për të zhvilluar aftësitë e nxënësit. Prindërit dhe nxënësi morën formularët e karakteristikave për plotësim.

Në takimin individual me Nartin të mbajtur me datën 25.09.2020, ai ka treguar interesim për shkencat e natyrës - lënda Biologji. Fokusi i tij më konkretisht është që deri në fund të vitit shkollor të mësoj më në thellësi për mutacionet gjenetike të pemët, perimet dhe kafshët.

Narti: Jam i kënaqur që do të punojë në qëllimin qe kemi përcaktuar, jam i interesuar të zgjeroj njohuritë e mia në këtë fushë.

Prindërit: Narti gjithmonë ka qenë shumë kureshtar për fushën e Biologjisë dhe ka realizuar eksperimente të ndryshme edhe në mënyrë të pavarur, prandaj jemi të kënaqur që do ta zhvillojë tutje këtë interesim**.**

Prindërit dhe nxënësi kanë plotësuar të gjithë formularët dhe janë pjesë e takimit të dytë të organizuar me 30.09.2019. Takimi u zhvillua në dhomën e takimeve me prindër. Takimin e tretë e realizuam me datën 10.10.2019 në kabinetin e biologjisë. Në këtë takim morën pjesë prindërit, psikologu i shkollës, mësimdhënësja e biologjisë dhe kujdestari i klasës. Ishte takim i gjatë dhe frytdhënës. Me informacionet e siguruara deri tani nga të gjitha palët, u identifikuan interesimet dhe nevojat e nxënësit në bazë të të cilave u caktuan qëllimet dhe objektivat e PI-së. Në të këtë takim u dakorduam që implementimi i planit të filloj që nga data 21.10.2019. Po ashtu, u dakorduam që e marta e parë e çdo muaji të jetë ditë takimi i grupit për të

monitoruar implementimin e planit. Për të gjitha takimet e realizuara janë mbajtur shënime.

Kujdestari i klasës bashkë me nxënësin u pajtuan që ai të përdorë listëkontrolle për të monitoruar dhe raportuar progresin e tij në takimet e planifikuara.

Anët e forta	***Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për përkrahje***
- Entuziast, i vetmotivuar - Aktivisht merr pjesë në aktivitete grupore, sidomos në lëndë shkencore - Aplikon me sukses njohuritë paraprake në situata të reja - I shkathët me teknologji - I pëlqen të lexoj përmbajtje komplekse shkencore - Shkathtësi në komunikim dhe shkrim në gjuhë të huaja	- Të zhvillojë strategji për të hulumtuar materiale shkencore në mënyrë të pavarur - Të orientohet dhe nxitet që të eksperimentojë në fushën e tij të interesimit.
Aspekte shëndetësore që ndikojnë në mësim	***Personi ndihmës***
Nxënësi nuk ka vështirësi shëndetësore të njohura deri më sot	Nuk ka nevojë.

Të dhëna nga vlerësimet formale

Testi	Data e testimit	Institucioni	Rezultati

Stanford–Binet Intelligence Scale: Fifth Edition	*12.07.2019*	Instituti ATOMI	*Shumë superiore >130*
Garat e diturisë në gjuhë shqipe në nivel shkollor	*10.06.2019*	*Shkolla "N.N "*	*Vendi i parë*
Gara e matematikës Kangaroo	*Mars, 2018*	*Instituti ATOMI*	*67%*
IQ Challenge	*Qershor, 2018*	*Shkolla "N.N"*	*Vendi i parë*

Niveli aktual i performancës	*Përfundimi i vitit shkollor*
Suksesi në periodën e parë ose periodën e dytë (shkruaj notat nga lëndët që janë relevante me qëllimet e PI). Gjuhë shqipe 5 Gjuhë angleze: 5 Gjeografi 5 Histori 5 Ed. Qytetare 5 Matematikë 5	*Suksesi në periodën e tretë:* Gjuhë shqipe 5 Gjuhë angleze: 5 Gjeografi 5 Histori 5 Ed. Qytetare 5 Matematikë 5 Biologji 5

Biologji	5	Fizikë	5
Fizikë	5	Art muzikor	5
Art muzikor	5	Art figurativ	5
Art figurativ	5	Ed. Fizike	5
Ed. Fizike	5	Informatikë	5
Informatikë	5		
Lëndët e preferuara: Narti identifikon shkencën si pasion të tij, në veçanti është i orientuar në Biologji.		Përkundër notës, ai raporton se ka pak vështirësi në lëndën e edukatës fizike.	

Përmbledhja e fundvitit

Shkathtësitë formuese (p.sh komunikimi, sjelljet e përshtatshme në klasë, motorika)

Qëllimet e arritura: ❑ të gjitha ❑ shumica prej tyre ❑ disa

Shkathtësi të përgjithshme (p.sh shkathtësi të cilat do ta ndihmojnë nxënësin të jetë i pavarur në shkollë, shtëpi dhe komunitet)

Qëllimet e arritura: ❑ të gjitha ❑ shumica prej tyre ❑ disa

Çfarë janë arritjet për këtë vit shkollor? *Prezantimi i tri hulumtimeve për mutacionet gjenetike.*
Çfarë ka funksionuar? *Duke pasur Plan Individual jam ndjerë më i nxitur dhe kam qenë shumë i motivuar që të punoj në arritjen e qëllimit dhe objektivave të planifikuara në PI.*

Çfarë nuk ishte efektive? *Nuk kam mundur të qasem në literaturë botërore ku kërkohet anëtarësim.*
Në çfarë duhet fokusuar vitin tjetër*? Vazhdoj të jem i interesuar të thellojë njohuritë e mija në fushën e gjenetikës.*
Çfarë qëllime duhen hulumtuar vitin tjetër? *Do të më pëlqente të vazhdoja hulumtime më të detajuara për gjenetikën e shpendëve.*

Qëllimi afatgjatë: Deri më 20 qershor 2020, Narti do të aftësohet të demonstrojë në praktikë shortimin në mes të dy pemëve dhe perimeve dhe do të prezentojë procesin me anë të tri prezentimeve në Poëer Point.		
Objektivat afatshkurta	***Procedurat e vlerësimit***	Rishikimi i progresit
1. Deri më 20 Nëntor 2019, Narti do të ketë njohuri themelore për shortimin si proces në botën bimore.	- Test me 20 pyetje për shortimin me kalueshmëri 80%. - Rishikim literature me shkrim (1000 fjalë). Kriteri i kalueshmërisë: Të jetë elaboruar saktë 80% e përmbajtjes.	Me sukses kam përfunduar objektivën e parë. Arritja ime në test ishte 82% ndërkaq në rishikimin e literaturës kam arritur 90%.
2. Deri më 24 shkurt 2020, Narti do të jetë i aftë të shpjegojë procesin e shortimeve te 4 pemët dhe 4 perimet duke realizuar 2 prezantime për to.	- Prezantim 15 sllajde në Poëer Point, i cili shpjegon bazën teorike të shortimit dhe të gjithë hapat për realizimin e tij. Prezentimi duhet të ketë së paku 5 ilustrime të procesit. Përmbajtja duhet të ketë rrjedhë logjike dhe konsistencë. Mos të ketë më shumë se 3 lëshime qoftë në përmbajtje apo volum.	Kam ndjekur udhëzimet e mësimdhënëses për të përfunduar prezantimet e mija dhe kam përmbushur kriteret e caktuara.
3. Deri më 20 Qershor 2020, Narti do të	- Vëzhgim i realizimit të eksperimentit. Kriteri i	Kam prezantuar para grupit punues

aftësohet të demonstrojë praktikisht procesin e shortimit përmes një eksperimenti.	kalueshmërisë: ndjekja e procedurave të realizimit të eksperimentit me jo më tepër se 1 gabim. - Shpjegim i procedurës eksperimentale, me saktësi 90%.	eksperimentin tim me sukses. Kam bërë 1 gabim në procedurë.
4.		
Qëllimi afatgjatë:		
Objektivat afatshkurta	***Procedurat e vlerësimit***	Rishikimi i progresit
1.		
2.		
3.		
4.		

Akomodimet dhe strategjitë për të përkrahur arritjen e qëllimit

Caktimi i takimeve javore për të shikuar progresin.

Shkolla i ka siguruar nxënësit një kompjuter të veçantë në kabinetin e biologjisë si dhe gjithë literaturën që ka biblioteka e shkollës.

Mësimdhënësja në vazhdimësi i ka ofruar materiale dhe linqe që i shërbejnë temës.

Mësimdhënësja e biologjisë i ka mundësuar Nartit ndjekjen e disa ligjëratave në degën e Biologjisë në FSHMN.

Ofrimi i mundësisë për të ndarë hulumtimet me bashkëmoshatarët edhe jashtë klasës.

Është liruar nga ora e matematikës gjatë orëve të përsëritjes për të mundësuar punën në qëllimin e PI.

I është mundësuar zbatimi i eksperimentit në FSHMN me studentë të degës së Biologjisë dhe demonstrimi final para grupit punues.

Informacione shtesë

Narti vijon mësimet edhe në shkollën e muzikës prandaj të gjitha takimet dhe aktivitetet shtesë për realizimin e qëllimit të caktuar me PI duhet të i organizojmë gjatë tri ditëve kur ai është i lirë.

Nënshkrimet

I kam të qarta dhe pajtohem me informatat e përfshira në këtë plan individual

X _____

Prindi

X _____

Drejtori i shkollës

X _____

Mësuesi apo Kujdestari i klasës

X _____

Psikologu i shkollës

Shtojca 3: Mostër e zbrazët e Planit Individual

PLAN INDIVIDUAL ***PËR NXËNËS ME INTELIGJENCË TË JASHTËZAKONSHME, DHUNTI E TALENTE***
Informata për nxënësin **Emri dhe mbiemri:** **Data e lindjes:** **Mosha:** **Klasa:** **Prindërit:** **E-mail:** **Tel:** **Adresa:**
Informata paraprake: Konteksti shkollor
Shkolla: **Mësuesi/ja apo kujdestari/ja i/e klasës:** **Mësimdhënësit e tjerë të përfshirë në realizimin e PI-së:** **Psikologu i shkollës:** **Palë të tjera jashtë shkollës:**
Informata paraprake: Përfshirja e prindërve dhe nxënësit

Anët e forta	***Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për përkrahje***
Aspekte shëndetësore që ndikojnë në mësim	***Personi ndihmës***

Të dhëna nga vlerësimet formale

Testi	**Data e testimit**	**Institucioni**	**Rezultati**

Niveli aktual i performancës	*Përfundimi i vitit shkollor*
Suksesi në periodën e parë ose periodën e dytë (shkruaj notat nga lëndët që janë relevante me qëllimet e PI) *Lëndët e preferuara:*	*Suksesi në periodën e tretë*

Përmbledhja e fundvitit

Shkathtësitë formuese (p.sh komunikimi, sjelljet e përshtatshme në klasë, motorika)

Qëllimet e arritura: ❑ të gjitha ❑ shumica prej tyre ❑ disa

Shkathtësi të përgjithshme (p.sh shkathtësi të cilat do ta ndihmojnë nxënësin të jetë i pavarur në shkollë, shtëpi dhe komunitet)

Qëllimet e arritura: ❑ të gjitha ❑ shumica prej tyre ❑ disa

Çfarë janë arritjet për këtë vit shkollor?
Çfarë ka funksionuar?
Çfarë nuk ishte efektive?
Në çfarë duhet fokusuar vitin tjetër?
Çfarë qëllime duhen hulumtuar vitin tjetër?

Qëllimi afatgjatë:		
Objektivat afatshkurta	***Procedurat e vlerësimit***	Rishikimi i progresit
1.		
2.		
3.		
4.		

Qëllimi afatgjatë:		
Objektivat afatshkurta	***Procedurat e vlerësimit***	Rishikimi i progresit
1.		
2.		

3.		
4.		

Akomodimet dhe strategjitë për të përkrahur arritjen e qëllimit
Informacione shtesë
Nënshkrimet
I kam të qarta dhe pajtohem me informatat e përfshira në këtë plan individual

X

Prindi

X

Drejtori i shkollës

X

Mësuesi apo Kujdestari i klasës

X

Psikologu i shkollës

Shtojca 4: Pyetësorët për prindërit

7 Pyetjet

Ky është pyetësor me 7 pyetje, i cili shërben për të asistuar në planifikimin e aktiviteteve shkollore për fëmijën. Zakonisht përgjigjet nga këto 7 pyetje shërbejnë si kornizë për planifikim ani pse duhet të ketë fleksibilitet edhe për perspektivën e fëmijës dhe mësimdhënësit, apo duhet shikuar relevancën e pyetjes në raport me qëllimet e prezentuara. Formati përfundimtar i planit individual do të varet nga nevojat e ndryshueshme të nxënësit apo të familjes.

- Marrja e informacioneve të nevojshme nga këto pyetje mund të zgjasë deri në 2 orë, të cilat mund t'i ndani në sesione të ndryshme.
- Informacionet dhe idetë e prindërve evidentohen në një letër përgjatë diskutimit.

1. Cila është historia e fëmijës suaj?
   (Informatat nga prindërit për këtë pikë janë vitale. Inkurajoni ata të ndajnë informacione të rëndësishme për zhvillimin e fëmijës së tyre duke përfshirë të dhëna për fazat e ndryshme zhvillimore, kur ka filluar të flasë, tiparet që e karakterizojnë, raporti me fëmijët e tjerë në familje etj.,)

2. Cila është ëndrra/ synimi juaj për të ardhmen e fëmijës suaj?
   (Inkurajoni prindërit të ndajnë me ju vizionin për të ardhmen e fëmijës së tyre, si e shohin ata, ta zëmë 5 vite prej tash, apo edhe si të rritur. Kjo do t'ju ndihmoj të orientoheni gjatë përpilimit të qëllimeve domethënëse)

3. Çfarë ju frikëson për të ardhmen e fëmijës suaj?
   (Është e rëndësishme të kuptoni këtë si element sepse mund të bëhet barrierë në krijimin e planit individual dhe duhet adresuar me kohë dhe duhet punuar për ta tejkaluar atë)

4. Përshkruani fëmijën tuaj me 3 fjalë?
   (Zakonisht prindërit identifikojnë dhe përshkruajnë karakteristikat që në sytë e tyre janë më të rëndësishmet me këto 3 fjalë.)

5. Cilat janë anët e forta/ dhuntitë/ aftësitë e fëmijës suaj?
(Kërkoni nga prindërit të ofrojnë shembuj konkret të këtyre aftësive, preferencave në sjellje apo çfarë din të bëj mirë fëmija i tyre.)

6. Për çka ka nevojë fëmija juaj?
(Identifiko nevojat nga perspektiva e prindit dhe më pas prioritizoni.)

7. Si do të dukej një ditë ideale në shkollë për fëmijën tuaj dhe çfarë hapash janë të domosdoshëm për t'u arritur kjo?

Pyetësor për prindërit

Emri i fëmijës:_____
Data:_____

Emri i prindit:_____

Pyetjet në vazhdim janë përpiluar ashtu që ta ndihmojnë grupin punues të planit individual në përpilimin e Planit Individual (PI) për fëmijën tuaj. Ne vlerësojmë jashtëzakonisht shumë kontributin tuaj në këtë proces, me ç' rast ju inkurajojmë të mendoni për pyetjet në vazhdim deri në takimin tonë të përbashkët.

- Çfarë do të cilësonit si anë të forta të fëmijës suaj dhe çfarë interesimesh ka ai?
- Përshkruani sukseset që ka pasur fëmija juaj në shkollë.
- Përshkruani sfidat me të cilat është ballafaquar fëmija juaj në shkollë.
- Cilat janë nevojat në të mësuar të fëmijës suaj për këtë vit shkollor? (Këto mund të jenë shkathtësi që konsideroni që duhet t'i ketë apo në të cilat duhet punuar tutje.)
- Si mëson fëmija juaj (shprehitë e tij)? Si mëson më së miri?
- A shfaqë fëmija juaj ndonjë sjellje e cila ju shqetëson? Nëse po, ju lutem sqaroni si merreni me këtë sjellje/ problematikë në shtëpi.
- Cilat janë qëllimet dhe shpresat për këtë vit shkollor?
- Ku e paramendoni fëmijën tuaj 5 vite më vonë?
- A ka ndonjë informatë tjetër e cila do të na ndihmonte të kuptojnë më mirë fëmijën tuaj?

- A ka ndonjë shqetësim/ çështje specifike që do të donit ta adresonim në këtë mbledhje? Nëse po, sqaroni.

Ju faleminderit që keni ndarë këto informacione me ne!

Vendosja e qëllimeve nga familja

Emri i nxënësit:
_____Data:_____

Emri i prindit:_____

Fëmija im ka këto anë të forta:

1.
2.
3.
4.
5.

Fëmija im ka këto nevoja:

1.
2.
3.
4.
5.

Qëllimi 1:

A. Qëllimi im i parë për fëmijën tim këtë gjysmëvjetor është:

_____
_____
_____
_____
_____

Për t'i ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi, unë do të angazhohem në shtëpi duke:

1.

2.

3.

Si do të sigurohem që të arrihet ky qëllim:

_____
_____
_____
_____
_____

Qëllimi 2:

A. Qëllimi im i dytë për fëmijën tim këtë gjysmëvjetor është:

_____
_____
_____
_____
_____

Për t'i ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi, unë do të angazhohem në shtëpi duke:

1.

2.

3.

Si do të sigurohem që të arrihet ky qëllim:

_____
_____
_____
_____
_____

Nënshkrimi i prindit _____

Data_____

Shtojca 5: Pyetësorët për nxënësit

Pyetësori i interesimeve të nxënësit

Emri dhe Mbiemri: _____

Klasa: _____

Shkolla:_____

Data:_____

Gjuhët që flet:_____

1. Shëno lëndën(t) e preferuar(a) në shkollë.
2. Shëno aktivitetet jashtëshkollore në të cilat je aktualisht i/e përfshirë.
3. Në çfarë klube/organizata bën pjesë jashtë shkollës? (Këtu mund të përfshihen edhe orët private, sikur kurset në fusha të ndryshme)
4. Numëro, trego 3 emisionet tua të preferuara
5. Listo 3 librat e tu të preferuar, dhe 3 autorë që pëlqen
6. Listo seksione gazetash, apo çfarëdo përmbajtje të cilën lexon rregullisht/ uebfaqe interneti.
7. Çfarë lojëra apo aktivitete preferon më së shumti
8. Cili është sporti yt i preferuar
9. Me çfarë sportesh merresh aktivisht (brenda dhe jashtë shkollës)
10. Listo shpërblimet që ke fituar (në çfarëdo fushe)
11. Për çfarë tematika të pëlqen të lexosh:
    □Komedi □Histori □ Gjithësi □Lojëra dhe puzzles
    □Njeriu □Sport □Tregime fantastiko- shkencore
    □Romancë □Tregime të shkurta □Të tjera _____
12. Kë konsideron hero, dhe pse (mund të jetë karakter historik/ imagjinar apo real)

13. Na trego për një person që ti njeh dhe që të duket interesant/ apo është i preferuari yt, dhe pse është ai/ ajo i preferuari
14. Ku ke udhëtuar deri tash dhe ku do të dëshiroje të udhëtoje
15. Listo punët e shtëpisë/ apo përgjegjësitë që ke në shtëpi
16. Çfarë karriere të duket interesante për momentin
17. Numëro tri gjëra që di të bësh më së miri në shkollë
18. Numëro tri gjëra për të cilat ke nevojë për ndihmë në shkollë
19. A e ke të lehtë të krijosh shoqëri të re? Numëro 3 shokë/ shoqe që i konsideron të afërt
20. Çfarë lëndësh të cilat nuk të ofrohen në shkollë do të dëshiroje të ndiqje
21. A ka ndonjë aftësi/ shkathtësi/ specifikë që do të doje të ndaje me arsimtarët/ mësuesen apo bashkëmoshatarët.

Pyetësori për mënyrën e preferuar të mësimit

Vendosni numrin 1, 2, ose 3 në kuti pas secilës deklaratë për të treguar preferencën tuaj:
3 = Shpesh, 2 = Ndonjëherë, 1 = Rrallë.

1. Unë më së miri mbaj në mend kur i them gjërat me zë ☐

2. Më shumë më pëlqejnë udhëzimet e shkruara sesa ato orale ☐

3. Kur jam duke mësuar, më pëlqen të përtypë çamçakëz, të ha ndonjë gjë, apo të luaj me diçka. ☐

4. Më së miri mbaj në mend gjërat kur i shoh të shkruara. ☐

5. Preferoj të mësoj përmes lojërave, simulimeve. ☐

6. Preferoj të mësoj kur dikush tjetër më sqaron/ shpjegon gjërat. ☐

7. Më së miri mësoj nga fotografitë, diagramet dhe tabelat. ☐

8. Më pëlqen të punoj me duar/ të ndërtoj gjëra. ☐

9. Më pëlqen leximi, dhe lexoj shpejt. ☐

10. Më tepër më pëlqen të dëgjoj diçka se sa ta lexoj përmbajtjen e njëjtë. ☐

11. Më pëlqen të jem afër të tjerëve. (Më pëlqejnë përqafimet, shtrëngimi i duarve dhe kontakti fizik me të tjerët) ☐

12. Më pëlqejnë librat audio, apo në përgjithësi përmbajtjet audio. ☐

13. Kur më kërkohet të shqiptoj një fjalë, unë thjesht e shoh fjalën në mendje. ☐

14. Kur mësoj material të ri, e gjej veten duke vizatuar, dizajnuar, skicuar. ☐

15. Kur lexoj në heshtje, ia "lexoj" secilën fjalë vetes. ☐

Në mënyrë që të kuptojmë preferencën e mënyrës si mëson, llogaritë shumën e pyetjeve:

Preferencë vizuale: Shuma e pyetjeve 2, 4, 7, 9, 13 =

Preferencë auditive: Shuma e pyetjeve 1, 6, 10, 12, 15 =

Preferencë taktile/ e prekjes: Shuma e pyetjeve 3, 5, 8, 11, 14 =

Shuma më e lartë tregon stilin apo preferencën tënde për mënyrën si mëson, ajo është _____.

Zbulo sfidat në të mësuar

Gjithmonë	Zakonisht	Ndonjëherë	Rrallë
Unë vij në shkollë çdo ditë.			
Unë vij me kohë në orët e mësimit.			
Unë marrë me vete pajisjet/ materialet e nevojshme për orën mësimore.			
Unë vij në orë të mësimit i përgatitur shembull: bëj detyrat, lexoj materialet e kërkuara.			
Unë i lë shqetësimet e mia jashtë procesit mësimor (nuk mendoj për to sa jam në shkollë).			
Mund të ndjekë udhëzimet e shkruara.			
Mund të ndjekë udhëzimet e thëna.			
Unë kuptoj konceptet e reja që mësimdhënësit prezantojnë.			
Unë mund të fokusohem, e të jem i vëmendshëm gjatë orës së mësimit.			
Unë kontribuoj në diskutimet që bëhen në klasë.			

Unë marrë shënime të sakta e të detajuara.

Fletoret e mia janë të organizuara.

Unë jam i qartë dhe konciz në të shkruar.

Puna ime me shkrim është e saktë, e lexueshme dhe e organizuar.

Përfundoj detyrat brenda afatit kohor të caktuar nga mësimdhënësi.

Unë di nga kush dhe kur të kërkoj ndihmë.

Mund të rri i qetë, pa lëvizur për një kohë të gjatë.

Unë nuk i shpërqendroj të tjerët duke folur me ta.

Arrij të ruaj qetësinë dhe fokusin në teste.

Jam i mirë në teste.

Emri i nxënësit:_____
Data:_____

Referencat:

1. Individualized Program Planning – Alberta Education Council, 2006
2. Understanding Special Education in the OCDSB Individual Education Plan Parent Guide – Ottaëa-Carleton District School Board, 2012
3. Talented Children and Adults: Their Development and Education – Jane Piirto, 2007
4. Exceptionally able students: Draft Guidelines for Teachers – National Council for Curriculum and Assessment, 2007
5. Nurturing Gifted and Talented Children: A Parent- Teacher Partnership– Jill Bevan-Broën and Shirley Taylor, 2008
6. Understanding and Challenging the Gifted: A Teacher's Handbook– Connecticut Association for the Gifted, 2008
7. The Journey – Handbook for parents of children ëho are gifted and talented. Alberta Learning, 2004.
8. UA14/2019 Udhëzimi administrativ për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti e talente.
9. UA 34/2014 Udhëzimi administrativ për shërbimet pedagogjike psikologjike në shkolla.